



RAPORTI VJETOR 2018

PËRMBAJTJA

1. Informacioni rreth shoqërisë.
 - 1.1 Informacion i përgjithshëm i shoqërisë.
 - 1.2 Misioni, vizioni dhe filozofia e shoqërisë.
 - 1.3 Profili i shoqërisë.
 - 1.4 Mesazh i Drejtorit të Përgjithshëm.
 - 1.5 Struktura qeverisëse.
 - 1.6 Simbolika dhe stilizimi i logos së re i shoqërisë Albsig.
 - 1.7 Albsig me ambiente të reja bashkëkohore.
 - 1.8 Albsig dhe mediat.
 - 1.9 Albsig dhe marketingu online përmes rrjeteve sociale.

2. Treguesit kryesore të aktivitetit të shoqërisë gjatë vitit 2018.
 - 2.1 Zhvillimet ardhurave nga primet sipas aktivitetit të shoqërisë gjatë vitit 2018.
 - 2.2 Projeksionet sipas portofoleve për vitin 2019.

3. Veprimtaritë kryesore gjatë vitit 2018.
 - 3.1 Analiza vjetore e veprimtarisë së Albsig.
 - 3.2 Tregu i Sigurimeve bashkëbisedim me Mediat.
 - 3.3 Albsig sh.a, mbështet këngëtarët e rinj dhe të njohur.
 - 3.4 Albsig mbështet shkrimtarët e rinj.
 - 3.5 Albsig mbështet sportistët e rinj.
 - 3.6 Albsig mbështetje për studentët ekselentë.
 - 3.7 Albsig, pjesë e Ditës së Karrierës “Hidh Hapin Tënd”.
 - 3.8 Albsig mbështet Festivalin e Filmit Ballkanik.
 - 3.9 Albsig mbështet Shoqatën e Arbëresheve Vorea.
 - 3.10 Albsig mbështet Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”.
 - 3.11 Albsig mbështet teatrin “Migjeni”.
 - 3.12 Albsig mbështet koncertin simfonik “Ndermendje”.

4. Politikat e monitorimit, administrimit dhe kontrollit të rrezikut të shoqërisë.
 - 4.1 Menaxhimi i riskut.
 - 4.2 Kuadri i Administrimit të Riskut / Struktura qeverisëse.
 - 4.3 Identifikimi dhe kategorizimi i risqeve.
 - 4.4 Analiza e riskut.
 - 4.5 Oreski i riskut dhe kufijtë e tolerancës së riskut të miratuara.
 - 4.6 Toleranca dhe kufijtë e riskut.
 - 4.7 Rreziku i cmimeve të sigurimit të detyrueshëm motorik.
 - 4.8 Ngritja e reputacionit për të zgjeruar bazën konkurruese.
 - 4.9 Planet e vijueshmërisë së veprimtarisë dhe përballimit të situatave të paparashikuara.
 - 4.10 Konkluzione.
 - 4.11 Rekomandime.
 - 4.12 Trendet e të ardhmes në industrinë e sigurimeve lidhur me risqet në rang global.

5. Raporti i Audituesit të Pavarur.
 - 5.1 Pasqyra individuale e pozicionit financiar.
 - 5.2 Pasqyra individuale e të ardhurave gjithëpërfshirëse.
 - 5.3 Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital.
 - 5.4 Pasqyra individuale e flukseve monetare.
 - 5.5 Shënimet shpjeguese të Pasqyrave financiare individuale.
 - 5.6 Skedule suplementare.

6. Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm për vitin 2018.
 - 6.1 Metodologjia dhe parimet e Auditimit të Brendshëm.
 - 6.3 Opinioni i Auditorit të Brendshëm.

7. Objektivat e shoqërisë për vitin 2019.

1. Informacioni rreth shoqërisë

Albsig sh.a. ("Shoqëria") është themeluar në vitin 2004 si një shoqëri sigurimi me vendndodhje në Shqipëri.

Shoqëria është një shoqëri aksionare me kapital të përbashkët, e regjistruar sipas Ligjit Shqiptar nr.7638,

Dt. 19 Nëntor 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë me vendim të Gjykatës së Rrethit të Tiranës, Nr. 28154, datë 9 Janar 2004.

Shoqëria operon sipas një liçense të lëshuar nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare ("AMF"), më përpara i njohur si Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve ("AMS"), për tregtimin e policave të përgjithshme të sigurimit sipas rregullave të AMF-së në territorin e Shqipërisë. Autorizimi për të ndërmarrë aktivitetet e sigurimit të jo-jetës është marrë më datë 19 Qershor 2004, ndërsa liçensa që specifikon klasat e aktiviteteve është lëshuar më datë 10 shtator 2004 nga AMS. Aktivitetet kryesore të biznesit përfshijnë dhënien e shërbimeve të sigurimit për mjetet motorike, pasurinë, shëndetin, dhe produkte të tjera të sigurimit jo-jetë.

Shoqëria ka 23 degë në Tiranë, Durrës, Dibër, Sarandë, Shkodër, Fier, Korçë, Elbasan, Vlorë, Lezhë, Kukës,

Gjirokastrë, Berat, Kavajë, Lushnjë. Më 31 Dhjetor 2017, shoqëria punësoi gjithsej 187 punonjës dhe drejtues (më 31 Dhjetor 2017: 151).

Gjatë vitit 2007 Shoqëria filloi aktivitetin në territorin e Republikës Maqedonisë nëpërmjet Albsig A.D.Shkup ("Filiali").

Filiali është 100% i zotëruar nga shoqëria e sigurimit ALBSIG sh.a. Tiranë, Shqipëri ("Shoqëria mëmë").

Filiali është regjistruar më 23 prill 2007, është vendosur dhe funksionon në Republikën e Maqedonisë.

Ai është liçensuar për të ofruar 11 klasa të sigurimit të jo-jetës. Shoqëria ofron shërbime të sigurimit në fushat e mjeteve motorike, pasurisë dhe ndaj aksidenteve.

Më datën 21 Nëntor 2017, Shoqëria Mëmë Albsig sha shiti 90% të aksioneve shoqërisë "XH & XH Teknologjia" shpk me Qëndër në Shkup (Republika Maqedonase).

Më 31 Dhjetor 2017 Albsig sha zotëron 10% të shoqërisë i quajtur "Nova insurance AD Skopje, pasi blerësit e rinj e ndryshuan emrin pas procedurave të kryera pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes të Sigurimeve Maqedoni.

Shoqëria Albsig sha ka Provigjione teknike të mbuluara me aktive dhe Aftësi paguese mbi nivelin e kërkuar nga ligji, si dhe një kapital në nivel 1,277,499,969 lekë (10.2 milion euro).



Misioni dhe vizioni

MISIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

VIZIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.

1.2 PROFILI I SHOQËRISË

Emri i Shoqërisë:	ALBSIG sh.a.
Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës: Z. Arben Breshani Znj. Ilda Muçmataj	Z. Shefqet Kastrati
Drejtor i Përgjithshëm:	Z. Muharrem BARDHOCI
Lokalizimi i zyrave Qëndrore:	Adresa: Rr. “Barrikadave”, 1001”, No. 10 - Tirana, Albania
Data e themelimit:	09 / 01 / 2004
Kapitali themeltar:	879,460,000 lekë
Numri i punonjësve:	187
Agjentë të lincësuar nga AMF:	99
Aktiviteti:	Në cilësinë e siguruesit të (Jo-Jetës)
Tel:	tel: +355 4 22 54 770 tel: +355 4 22 54 76
Website:	www.albsig.al
Kontakt:	info@albsig.al



1.3 Mesazh i Drejtorit të Përgjithshëm.

Hala përshëndetëse e Drejtorit të Përgjithshëm, z. Muharrem BARDHOCI

Më lejoni t'ju falenderoj për interesimin tuaj konstant për ALBSIQ.

26 nga themelimi në vitin 2004, ALBSIQ është ndër të paketat shoqëri që ka ruajtur trendin pozitiv dhe që vit pas viti ka konsoliduar pozitën në treg. Sigurisht, kjo rrugë konstante vjen si rezultat i investimeve dhe mbështetjes së vazhdueshme të Grupit Kastrati.

ALBSIQ për të tretin vit rradhazi ka patur trendin më të lartë të rritjes. Aktualisht për vitin 2018 pozicionohemi të dytët në treg dhe kjo sigurisht është tregues i besimit të klientëve. Konkurrenca në tregun e sigurimeve është shumë e madhe, megjithatë në vite ia kemi dalë të ruajmë dhe forcojmë pozitën tonë dhe të shtojmë numrin e klientëve. Ne i kushtojmë rëndësi primare marrëdhënieve me klientët. Ekspertët tanë mundësojnë këshillim financiar të personalizuar për secilin prej tyre, individë apo kompani dhe pikërisht falë kësaj filozofie kemi ndërtuar një marrëdhënie afatgjatë dhe të konsoliduar në vite. Një nga prioritetet e ALBSIQ gjatë viteve të fundit ka qënë dhe zgjerimi i rrjetit të pikave të shërbimit dhe aktualisht jemi të kundërdodhur në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Por, krahas zgjerimit dhe modernizimit të shërbimeve tona në çdo pikë shitjeje, po investojmë qjerësisht dhe në përmirësimin e shërbimeve online. Synojmë të ofrojmë zgjidhje më të thjeshta, të cilat do të mund të përdoren lehtësisht nga klientët tanë në çdo kohë, 24 orë në 7 ditë të javës.

Kemi investuar dhe do të vazhdojmë të investojmë në implementimin e shërbimeve elektronike dhe prioriteti ynë kryesor është ofrimi i shërbimeve që mundësojnë përfitime të qëndrueshme për klientët tanë; shpejtësi në plotësim të nevojave pa kufizime në kohë, me transparencë dhe procedura të thjeshtuara.

Kultura korporative dhe modeli i biznesit që aplikojmë si pjesë e Grupit Kastrati, na lejon që të kemi avantazhe të shumta, të tilla si reagimi dhe përshtatja e shpejtë ndaj ndryshimeve në treg dhe gjithashtu na mundëson që të kemi rol kryesor në cilësinë e shërbimeve që ne u ofrojmë klientëve tanë. Jemi pjesë e një prej grupeve më të mëdhenj dhe më të suksesshëm në Shqipëri dhe rrjedhimisht kjo mundëson më shumë siguri dhe më shumë përfitime për klientët tanë.

Duam të jemi zgjedhja e parë e shqiptarëve dhe t'u japim ulerë shërbimeve që ofrojmë. Jemi të përkushtuar për të ruajtur dhe konsoliduar besimin e klientëve tanë. E themë ndryshe, ne në ALBSIQ nuk ofrojmë thjesht produkte dhe shërbime, por kujdesemi në çdo detaj për klientët tanë. Ajo që na diferencon, është pikërisht cilësia e produkteve dhe shërbimeve të ofruara.

Faleminderit për mbështetjen e vazhdueshme.

Me respekt,
Muharrem Bardhoci


Z. Muharrem Bardhoci
Drejtor i Përgjithshëm

1.4 Struktura Qeverisëse

QEVERISJA E SHOQËRISË

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve

Shoqëria ALBSIG sh.a është në pronësi të 4 aksionarëve individual

Z. Shefqet Kastrati

Z. Lokol Xhaja

Znj. Frida Mucmata

Znj. Natasha Dhoqina

Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

Z. Shefqet Kastrati

Z. Arben Breshani

Znj. Ilda Muçmataj

Komitetet

1. Komiteti i Administrimit të Riskut

2. Komiteti i Auditimit

Drejtor i Përgjithshëm

Z. Muharrem Bardhoci

Departamentet / Degët

ALBSIG është i organizuar në 7 Departamente.

ALBSIG ka 23 degë, të vendosura në çdo qytet në Shqipëri.

Numri i të punësuarve është 187

Kapitali i nënshkruar

Kapitali i paguar i shoqërisë më 31 Dhjetor 2014 është 879,460 mijë

Lekë

Kapitali se bashku me fitimin e mbartur me kapital 1,277,499,969

lekë (10.2 milion euro)

1.5 Veprimtari sigurimi jo-jetë, në klasat e sigurimit më poshtë:

Liçenca i jep të drejtën Shoqërisë së Sigurimeve Albsig Sh.a e kryerjes së operacioneve të sigurimit në cilësinë e operatorit të Jo-Jetës sipas grupeve të sigurimit të listuara më poshtë:

- * Grupi nr. 1 "Aksidente"
- * Grupi nr. 2 "Sëmudjet"
- * Grupi nr. 3 "Mjete tokësore" (të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina)
- * Grupi nr. 4 "Mjete lëvizëse mbi shina"
- * Grupi nr. 5 "Avionët"
- * Grupi nr. 6 "Anijet"
- * Grupi nr. 7 "Mallrat në transport"
- * Grupi nr. 8 "Zjarri dhe forcat e natyrës"
- * Grupi nr. 9 "Dëmtime të tjera të pasurisë"
- * Grupi nr. 10 "Përgjegjësitë civile nga përdorimi i automjeteve"
- * Grupi nr. 11 "Përgjegjësitë civile nga përdorimi i avionëve"
- * Grupi nr. 12 "Përgjegjësitë civile nga përdorimi i anijeve"
- * Grupi nr. 13 "Përgjegjësitë civile të përgjithshme"
- * Grupi nr. 15 "Garancitë"

1.6 Simbolika dhe stilizimi i logos se re i shoqërisë Albsig

Gjatë këtyre viteve, strategjia kryesore e ALBIG ka qenë dhe është rritja e cilësisë së shërbimit, zgjerimi i pikave të shërbimit, dhe zgjerimi i investimeve. Prej mëse dy vitesh jemi lider në disa shërbime dhe renditemi të dytët për sigurimevet vullnetare e të tjera shërbime. Vëmendja jonë përveç rritjes së cilësisë së shërbimit, është përqëndruar në krijimin e një strukture të veçantë Kujdesi ndaj Klientit dhe në këtë drejtim janë kryer investime serioze.

Kultura korporative dhe modeli i biznesit që aplikojmë si pjesë e Grupit Kastrati, na lejon që të kemi avantazhe të shumta. Ofrimi i shërbimit sipas standardeve më bashkëkohore në treg, janë në fokusin e ALBSIG dhe të gjitha kompanive të Grupit Kastrati, i cili vitet e fundit ka investuar dhe vazhdon të investojë në aplikimin e teknologjisë më të avancuar europiane.

Strategjia jonë e zhvillimit është rritja e vazhdueshme e cilësisë së shërbimit. Duam të jemi zgjedhja e parë e shqiptarëve në sektorin ku operojmë dhe t'u japim vlerë shërbimeve që ofrojmë. Jemi të përkushtuar për të ruajtur dhe konsoliduar besimin e klientëve tanë. E thënë ndryshe, ALBSIG nuk ofron thjesht produkte dhe shërbime, por kujdeset në çdo detaj për klientët e tyre.

Por, krahas zgjerimit dhe modernizimit të shërbimeve tona në çdo pikë shitjeje, po investojmë gjerësisht dhe në përmirësimin e imazhit dhe shërbimeve online.

Pas, 14 vitesh që operojmë në treg, jemi zhvilluar dhe kemi përmirësuar ndjeshëm gamën dhe cilësinë e produkteve dhe jemi ndër shoqëritë me të mira në treg.

Sigurisht, pas 14 vitesh mendojmë që është momenti për një përshtatje dhe të fytyrës së shoqërisë më atë që përfaqësojmë dhe gjatë këtyre viteve, koha, trendi dhe çdo gjë ndryshon me hapa të shpejtë. Kjo besnikëri dhe kënaqësi duam që të jetë e konsoliduar që nga logoja, e cila duam që të na përfaqësojë denjësisht në çdo kuptim (shërbime; cilësi, inovacion).

Logoja (apo siç njihet nga anglishtja "Brand") është identiteti i një biznesi, produkti, apo shërbimi. Në karakteristikat e logos, përveç emrit bëjnë pjesë edhe shenja dalluese, simboli unik, ngjyra, lloji i shkrimit (fontit), apo dhe një slogan i caktuar.

Aktualisht është e nevojshme që kuptimi fillestar i logos dhe sloganit të Albsig të evoluohet duke përfshirë edhe personalitetin e biznesit që përfaqëson dhe mënyra e perceptimit të saj nga konsumatorët.

Logoja ose emblema e re e Albsig, e propozuar dhe stilizuar Digital Agency/ TOK, është një rikonceptim minimalist, duke ruajtur të njëjtat ngjyra dhe duke rikonceptuar vizualisht simbolin e deritanishëm të ALBSIG.

Në thelb, ndryshimi i llojit të shkrimit (fontit), i cili është është një lloj shkrimi i plotë me forma rrethore dhe që përshtatet plotësisht në të gjitha mënyrat e përdorimit në materialet e printuar dhe hapësitat dixhitale, është shoqëruar dhe më një ridimensionim të simbolit duke e përshtatur me formën dhe madhësinë e shkrimit. E thënë ndryshe, logoja e re e zhvendos imazhin e shoqërisë në një stad të ri, duke i dhënë një avantazh në raport me konkurrentët. Logo e re integron vizionin, kulturën, vlerat e shoqërisë, duke formuar një vlerë unike dhe të plotë, ashtu sikundër përfaqëson "rrethi" (të plotën).

Pra, logoja e re është simplice dhe më moderne, dhe përfaqëson një vlerë unike të shoqërisë në perceptimin e klientëve.

Logoja e korporativit ka një trashëgimi të pasur, asete dhe aftësi, njerëz, vlera dhe prioritete, elemente referenciale lokale ose rajonale, programe që lidhen me qytetarët dhe regjistrat të performancave historike.

Duke ruajtur simbolikën e logos aktuale, dizajni ajo që përfaqëson logo e re është më e thjeshtë për t'u fiksuar dhe për të ngelur në mendjen e konsumatorëve. Janë ruajtur me delikatese elementet vizuale nga brandi i vjetër në mënyrë që të mos largohet shumë nga perceptimi i publikut.

Konkretisht do të ruhet emri, ALBSIG (kësaj here do përdoret vetëm në kapitale dhe ngjyra e logotipit të mëparshëm të shoqërisë).

Meqenëse Albsig është pjesë e Kastrati Group, logoja e së cilit është përkrenarja e heroit kombëtar Skënderbeut, është dashur të paraqitet një logo, e cila tregon vlerat, fuqinë, krenarinë dhe vetëbesimin ndaj konsumatorëve dhe jo vetëm.

Dominuese në logon e re të Albsig është simbolika e shqiponjës e stilizuar në mënyrë moderne për të shpalosur karakterin dinamik dhe vizionin e qartë të shoqërisë. Simbolika e shqiponjës është e njohur nga kulturat e historisë së njerëzimit që nga kohët e lashta në mesjetë e deri në epokën e teknologjisë në të cilën jetojmë.

SIMBOLI DHE STILIZIMI

SHQIPONJA SI ASET, FORCE
DHE KRENARI



Logoja do të ketë kompletet e gërmave elegante të cilat marrin frymëzim nga kultura antike si ajo romake apo helene sepse pasqyrojnë forcë, seriozitet dhe vazhdimësi.


Fontet sans serif, në formën e tyre bold japin një përqasje më të kurajshme sidomos kur germat janë kapitale. Pasqyrojnë kurajo, stabilitet dhe jetëgjatësi në identitetin ku aplikohen.



Tipologjia e fontit modern vjen si një font me kënde të forta dhe në formën medium.

Germet japin siguri, elegancë dhe dinamikë. Ndërsa simboli i logos është mbështetur nga forma klasike e Shqiponjës Kombëtare për t'a nxjerr një variant simbolik që fokusohet tek koka e një shqiponje që sheh të ardhmen dhe simotrat europiane lider në fushën e sigurimeve.


Mburoja është një element stilistik që identifikohet dhe haset shpesh në fushën e sigurimeve e ndërthurur me krahët në një koncept të vetëm.






1.7 Albsig me ambiente të reja bashkëkohore.


Prej më shumë se 6-muajve Albsig është akomoduar në ambientet e reja të qendrës së njohur tashmë si “Pallati Albsig” në rrugën e Barrikadave Albsig HQ 1001 Tiranë. Albsigu është e para shoqëri sigurimesh e cila tashmë njihet si shoqëria me ambientet më bashkëkohore në vend. Albsigu i ri, në Tiranë është ndërtuar përmes një investimi prej miliona eurosh investim nga buxheti dhe mbështetja e Grupit Kastrati. Ndryshimi i ambienteve vjen si një domosdoshmëri për Shoqërinë, sepse kjo e fundit është zgjeruar dhe është pozicionuar në vendin e dytë në tregun e sigurimeve, zgjerim ky i shoqëruar dhe me rritjen e numrit të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme. Ambientet e reja të drejtorisë së përgjithshme të Albsig janë të ndara në dy kate. Në katin e parë është pozicionuar dhe zyra e shitjeve, ku përmes së cilës orientohen klientët. Ndërsa në katin e dytë janë pozicionuar të gjitha departamentet kryesore. Ajo që bie në sy në ambientet e reja të Drejtorisë është dhe salla e konferencave, që është e pajisur me të gjitha standartet bashkëkohore. Në këtë të fundit tashme zhvillohen trajnime, konferenca dhe analiza të ndryshme.







1.8 Albsig dhe mediat.

Rëndësia e sigurimeve është një ndër pikat kryesore e cila përmes pasqyrit në Media ndikon në edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut. Mediat e shkruara edhe pse në dukje u ka rënë niveli i lexueshmërisë serish ato janë në qëndër të vëmendjes përta i përket informimit të publikut. Kanë qënë vetë mediat ato që kanë vënë në dukje rëndësinë e sigurimeve vullnetare si dhe arritjet e Albsig në tregun e sigurimeve për vitin 2018. Kulmi i arritjeve në Albsig përgjatë viti 2018 është pasqyruar dhe në mediat e ndryshme. Ky pasqyrim i drejtpërdrejtë në mediat më të lexuara ka bërë që publiku të njihet me të gjitha proceset në progres dhe jo vetem të cilat e kanë shoqëruar shoqërinë përgjatë vitit 2018.






1.9 Albsig dhe marketingu online përmes rrjeteve sociale.

Media sociale, edhe pse një fenomen relativisht i ri, është bërë një pjesë gjithnjë e më e rëndësishme e marketingut të Albsig. Shoqëria ka zbatuar një platformë bashkëkohore e përshtatur për të njohur e zhvilluar produktet dhe për të edukuar konsumatorët. Zbatimi i kësaj platforme duket se i vjen në ndihmë rritjes së bazës së klientelës dhe i mban lidhur për cdo risi apo njoftim që nxjerr shoqëria.

Perceptimi i marketingut nëpërmjet medias sociale nuk shikohet më në këndvështrimin e një trendi i cili do të fashitet shpejt apo do ti zbehet rëndësia. Tashmë fleksibiliteti dhe mirëmenaxhimi i prezencës internetike të Albsig është bërë një domosdoshmëri për shoqërinë. Prania e Albsig në të ashtuquajturën "Treshja e Madhe" (Facebook, Instagram, Google) është tashmë kusht që shoqëria të mund të operojë sukseshshëm si në tregun tradicional ashtu edhe në atë dixhital.



2. Treguesit kryesorë të aktivitetit të shoqërisë gjatë vitit 2018

2.1 Zhvillimet kryesore të aktivitetit të shoqërisë gjatë vitit 2018

Shoqëria Albsig Sh.a. edhe gjatë vitit 2018 rezulton me një rritje të ndjeshme prej 19.67 % kundrejt 2017 duke patur rritjen më të madhe në tregun e sigurimeve jo-jetë.

Prezenca e Albsig sh.a. në treg është rritur, nga 13.10 % për vitin 2017 dhe në 14.87 % për vitin 2018. Kjo rritje e rendit shoqërinë Albsig në vend të dytë në tregun e sigurimeve jo – jetë.

Kjo është rrjedhojë e një pune shumë rezultative në linjat e produkteve vullnetare sidomos të Pronës, në produktin Kasko, Portofoli “Aksidente dhe Shëndet” dhe në vecanti produkti Sigurimi i Shëndetit.

Shoqëria edhe për vitin 2018 përsëri renditet e para në tregun e sigurimeve për produktin Kasko, e dyta për sigurimet vullnetare duke patur raportin më të lartë në treg 51.25 %.

Për linjat e detyrueshme motorike, prezenca në treg për vitin 2018 është 10.62 % nga 10.50 % në për vitin 2017. Për sigurimet vullnetare, prezenca në treg për vitin 2018 është 23.98 % nga 18.35 % në vitin 2017 duke u pozicionur në vend të dytë.

Numri i kontratave në sigurimin e Jo-Jetës për vitin 2018 është 1,176,826 duke shënuar një rritje në masën 8.24 % krahasuar me vitin 2017.

Ndërsa numri i kontratave të Albsig është rritur në masën 8.67 % .

Për vitin 2018 rritja totale e tregut të sigurimeve jo - jetë është 5.48 %, ndërsa rritja e Albsig sh.a. është 19.67 % duke patur rritjen më të madhe në treg.

Në totalin e të ardhurave nga sigurimet për herë të parë në veprimtarinë e shoqërisë Albsig kanë predominuar sigurimet vullnetare 51.25 % për vitin 2018, ndërsa sigurimet e detyrueshme motorike (TPL, Kartoni Jeshil dhe Sigurimi Kufitar) që përbëjnë rreth 48.75 % të të ardhurave nga primet.

Realizimi i primeve për vitin 2018 kundrejt planit është në masën rreth 5.8 % ku realizim të ndjeshëm kundrejt planit kanë patur Drejtoria Qendrore, Dega Durrës 2, dhe realizim të planit Dega Shkodër, Dega Durrës 1, Dega Aden Jashari Tiranë, Dega Laprakë Tiranë dhe Dega Kukës. Degët me realizimin më të ulët janë, Dega Peshkopi, Dega Gjirokastër dhe Dega Elbasan.

2.2 Projektionet sipas portofoleve për vitin 2019

Arritjet dhe përvoja e deritanishme, objektivat e synuara, avantazhet dhe dizavantazhet që prezanton tregu i sigurimeve, shërbejnë si bazë dhe në tërësi reflektohen në programin ekonomik-financiar të vitit 2019. Programi garanton efektivitetin e shpenzimeve, sikundër edhe zhvillimin e mëtejshëm, konform standarteve ligjore dhe rritjen e potencialeve financiare të shoqërisë.

Shoqëria Albsig duke iu referuar analizave të ndryshme në lidhje me tregun, konkurentët dhe analiza të tjera përpilon projeksionet e planit për vitin pasues. Gjatë gjithë kohës projeksionet e shoqërisë janë llogaritur saktë sepse përcaktohet nga persona në një skuadër të cilët janë të aftë për të lexuar përfundimet e këtyre analizave në shërbim të vendimeve pasuese të marra në rang shoqërie

3. Veprimtaritë kryesore gjatë vitit 2018

3.1 Analiza vjetore e veprimtarisë së Albsig, 2018

Viti 2018 do të mbetet një ndër vitet me të arritshme për Albsig. Albsig përvec takimeve të njëpasnjëshme jo vetëm me drejtuesit e degëve dhe të nën-degëve të shoqërisë organizon dhe analizon punën e bërë për periudha të ndryshme. Analiza e punës është një proces tashmë i bërë traditë në Albsig, pasi kjo e fundit u mundëson menaxherëve që nëpërmjet informacioneve, analizave dhe njohurive që disponojnë, të përcaktojnë numrin e nevojshëm të njerëzve për plotësimin e tyre, si dhe të përcaktojnë objekat dhe hapat e nevojshëm për rritjen, zhvillimin dhe konsolidimin e shoqërisë e cila aktualisht është lider në treg për produkte vullnetare. “Viti 2018 do të mbetet për Albsig si viti më i arritshëm dhe me i suksesshëm në të gjitha fushat. Në sajë të punës së mirë planifikuese, organizuese e drejtuese, bëri të mundur që gjatë këtij vitirezultatet në shumë fusha të kenë një rritje nga më të mirat ndër vite. Në sajë të masave organizative e efektive, Albsig vlerësohet si shoqëria me trendin më të lartë të rritjes për 3-vitet e fundit”, tha në fjalën e hapjes së analizës vjetore z. Muharrem Bardhoci Drejtori i Përgjithshëm i Albsig. Ai shtoi se gjatë vitit 2018 shoqëria realizoi një shifër neto afarizmi në shumën prej, 2 338,161 270 mije leke, nga 1,953,429 mije lekë në vitin 2017.

Veprimtaria gjatë 2018 u përqëndrua në zbatimin e prioriteteve dhe objektivave të vendosura nga Drejtuesit e Shoqërisë të mbështetur nga presidenti i Kastrati Group si pjesë e fuqishme e këtij grupi biznesi, si dhe në plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore, rregullore dhe aktet e brendshme dhe të Albsig.

Në analizën vjetore të Albsig marim pjesë të gjithë punonjësit e Albsig duke përfshirë këtu dhe drejtuesit e degëve nëpër rrethe pasi këta të fundit janë dhe hallka kryesore e zinxhirit të shitjeve të shoqërisë. Analiza e punës vjetore e Albsig u mbyll me sukses për tu pasuar në takimin e radhës.



3.2 Tregu i Sigurimeve bashkëbisedim me Mediat.

Organizuar nga Shoqata e Siguruesve

“Tregu i Sigurimeve bashkëbisedon me mediat”, kështu është tulluar takimi i realizuar nga Shoqata e Siguruesve me mediat dhe Shoqëritë e Sigurimeve.

Shoqatat e sigurimeve në një bashkëbisedim me mediat evidentoi sfidat me të cilat tregu i sigurimeve përballet sot. Edvin Libohova, në emër të Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë deklaroi se ky event është i rëndësishëm pasi përkoji dhe me 15 vjetorin e krijimit të kësaj shoqate.

Ndërgjegjësimi i mediave dhe njohja me produktet vullnetare të sigurimeve, kanë qenë disa nga synimet e tjera të takimit të realizuar në qyte në Durrësit. Plarent Hamzaj, zv Drejtor i Përgjithshëm i Shoqërisë së sigurimeve Albsig.sh.a, bëri të mundur njohjen e pjesmarrësve me sigurimin e pronës problema kat dhe nevojat që ka tregu për sigurimet e pronave. Si dhe rolin që luan media në ndërgjegjësimin e bizneseve për pajisjen e pronave tyre me sigurim.



3.3 Albsig sh.a, mbështet këngëtarët e rinj dhe të njohur

Koncerti “Hapësira e një ëndrre”, i këngëtarit Alban Skënderaj

Koncertin u realizua në datën 2 mars në Pallatin e Kongreseve shoqëruar nga mbi 65 orkestrantë të orkestrës simfonike të RTSH e cila u drejtua nga Gridi Kraja.

Koncerti i konceptuar në stilin Alban&Friends ishte një koncert pop-klasik, ngërtheu edhe disa surpriza, por zbuloi edhe anën modeste të karakterit të Alban Skenderajt se si e përjeton ai suksesin e përseritjes së koncertit për 3 mbremje rresht.

Në njërën prej netëve të transmetimit të koncertit të këngëtarit morën pjesë dhe stafi i Albsig. Andaj Albsig, duke dashur të promovojë dhe mbështesë trashëgiminë kulturore dhe sidomos këngëtarët e mirefilltë shqiptarë është gjithmon mbështetës i eventeve të tilla.

3.4 Albsig mbështet shkrimtarët e rinj

Për disa vite me radhë, Albsig.sh.a pjesë e Kastrati Group është sponsor dhe mbështetës i shkrimtareve të njohur dhe të rinj.

Shkrimtarët e rinj me veprat e tyre si në fushën e letërsisë ashtu dhe në atë të historisë ndërtojnë një lidhje mes anës shpirtërore dhe asaj reale të njeriut dhe e afirmojnë mendimin kulturor, historik.

Motivi kryesor për përfshirjen në këto projekte është që shkrimtarëve të njohur dhe të rinj t’iu mundësojë zhvillimin e një frymë të shëndetshme dhe aftësi krijuese, për tu edukuar dhe integruar plotësisht në rrymat letrare që ata përfaqësojnë.

Vazhdimi i bashkëpunimit me Shkrimtarët dhe mbështetja e këtyre projekteve konfirmon përpjekjet e Albsig për një qasje afatgjatë dhe sistematike për tu ardhur në ndihmë në përputhje me planet strategjike të Albsig në fushën e përgjegjësive sociale.

Ne të gjithë besojmë në një të ardhme më të mirë, por vizioni për të ardhmen nënkupton pranimin e përgjegjësisë për atë që po ndodh sot në shoqëri, për të nxitur ndryshimet, si në sektorin tonë profesional, ashtu edhe në komunitet në përgjithësi.

Në kuadër të mbështetjes së mëtejshme të artit dhe kulturës Albsig thajse për cdo vit mbështet si sponsor shkrimtarët e rinj. Këtë vit ndryshe nga vitet e tjera mbështet shkrimtarin dibran z. Sakip Cami me librin e tij të fundit mbi hulumtimet që ai ka bërë në zonën e Dibrës për heronjtë e asaj zone. Hulumtime historike dhe fakte reale të pathëne ndonjëherë do të jenë ekskluzive në librin e ri i cili del në treg këtë periudhë.

3.5 Albsig mbështet sportistët e rinj.

Shoqëria e Sigurimeve Albsig njihet si promotorja dhe mbështetësa kryesore në fushën e sportit, artit dhe kulturës, duke mbështetur financiarisht dhjetëra aktivitete që janë zhvilluar brenda dhe jashtë vendit. Albsig një ndër mbështetëset kryesore të boksierit lezhian Jurgjen Uldedaj.



I cili njihet që ka 9 fitore dhe asnjë humbje në karrierën e tij si profesionist, ndeshja është zhvilluar në datën 15 Dhjetor në sallën “Feti Borova”, pranë Tiranë Olimpik Park duelin e vlefshëm për titullin kampion bote në kategorinë WBO Junior dhe sfida u zhvillua në peshën “cruiserweight”.

Boksieri shqiptar, Jurgjen Uldedaj është kampioni më i ri i Botës në disiplinën Junior të WBC.

Jurgjen Uldedaj, 21 vjeç mposhti me pikë polakun, Krzysztof Twardowski, duke triumfuar me pikë 97-93. Një fitore historike kjo për Uldedaj, që bëhet boksieri i parë shqiptar që fiton këtë titull.

Ky triumf vjen vetëm një vit pas fitimit të titullit të kampionit të Botës, WBO.

Në atë duel, Uldedaj mposhti argjentinasin, Nicolas Leandro Arganaraz. Kjo është fitorja e 11-të e Uldedaj në 11 ndeshje, duke ruajtur kështu pathyeshmërinë në ring. Lezhiani prej 3 vitesh ka nisur karrierën e tij si boksier profesionist, duke u stërvitur me ekipin gjerman të SES Boxing. Në Shkurt të këtij viti, Uldedaj fitoi titullin “International German Master” dhe tani po hedh një tjetër hap të rëndësishëm në karrierën e tij.



3.6 Albsig mbështet studentët ekselentë.

“Të jesh një student ekselent, është privilegj, sepse ti mban një titull vlerësimi që të përfaqëson jo vetëm ty si individ, por gjithashtu të njeh edhe kontributin e punës së palodhur, angazhimin dhe dashurinë e reflektuar mbi botëkuptimin e dijeve, ideve të tua.

Një prezantim hyrës i shkurtër që tregon një pjesë të rëndësishme të përkushtimit tënd të madh të jetës dhe një falenderim i madh për ata që të mbështesin për të realizuar ëndrrën tënde”, ky është një ndër mesazhet që përcjell Ensuida Hafizi nga qyteti i Tiranës , e cila tashmë ka prekur ëndrrën e saj për realizimin e mundësisë së studimeve në Londër.

Hafizi është studentja që i është mundësuar financiarisht një bursë studimi nga Albsig. Ky kontribut vjen në kuadër të aktiviteteve të organizuara nga shoqëria, në ndërmarrjen e hapave konkretë për krijimin e mundësive të studimeve jashtë vendit për studentët ekselentë.

Tashmë kjo nismë e ndërmarrë nga Kastrati Group është shndërruar në një traditë vlerash që ndiqet e pasurohet ndër vite edhe nga bizneset e tjera pjesë të grupit të cilat bëjnë të mundur mbështetjen financiare të studentëve ekselentë.

Shoqëria e Sigurimeve Albsig pjesë e Kastrati Group mbështet studentët, me qëllim të aftësisimit dhe fuqizimit të mëtejshëm të kuadrove potencial njëkohësisht do të vazhdoj mbështetjen financiare dhe për vitin e ardhshëm akademik duke mundësuar për bursa të tjera.

3.7 Albsig, pjesë e Ditës së Karrierës “Hidh Hapin Tënd”,

“Hidh Hapin Tënd”. Dita e Karrierës 2018. Organizuar nga Fakulteti Ekonomisë, Universiteti i Tiranës zhvilluar më dt.19 prill 2018.

Në panairin e “Ditës së karrierës”, morën pjesë 60 kompani të cilat, ekspozuan ofertat e punës në Fakultetin e Ekonomisë, ku mes tyre ishte dhe Albsig pjesë e Kastrati Group.

Albsig është spikatur tashmë si mbështetëse e brezave të rinj në rrugën e Karrierës.

Albsig së bashku me kompanitë e pranishme në event ekspozuan ofertat mbi praktikatat mësimore, internshipet, mundësitë e punësimit, trajnimet dhe workshopet.

Albsig.sh.a pjesë e Kastrati Group ka qenë dhe është gjithmonë e hapur ndaj punëkërkuessve të rinj, me dëshirë për të mësuar dhe për të zhvilluar edhe më tej aftësitë profesionale, duke u dhënë hapësirën e kërkuar për të përfituar sadopak eksperiencë në fushën e sigurimeve.

Shoqëria e Sigurimeve Albsig ofron mjedisin e duhur për zhvillimin profesional dhe mundësinë e aplikimit të aftësive për profesionistët, njëkohësisht mbështet shumë fort dhe brezin e ri të studentëve.

Stendën e Albsig e vizituan dhe aplikuan rreth 150 studentë ku shumica prej tyre përveç kërkesave për internshipet kërkuan dhe mundësi punësimi dhe praktikimi. Në kuadër të mbështetjes së studentëve pjesmarrës në panairin “Dita e Karrierës” Albsig, u bëri të mundur që 20 prej studentëve më të mirë pjesmarrës në panair të bëjnë praktikatat dhe internshipin pranë departamenteve përkatëse të shoqërisë.



3.8 Albsig mbështet Festivalin e Filmit Ballkanik.

Albsig mbështet dhe zhvillimet në fushën e kinematografisë.

Në datën 2 -7 Korrik është zhvilluar Festivali I Filmit Ballkanik në Kinemanë “Lasgush Poradeci” në Pogradec. Ky eveniment është realizuar me pjesmarrës jo vetëm nga Shqipëria por nga i gjithë Ballkani.

Festivali ka zgjatur për një periudhë kohe 1- javore ku kineastët kanë mundur të shfaqin jo vetëm risitë por edhe problematikat që mbart kjo fushë.

3.9 Albsig mbështet Shoqatën e Arbereshëve Vorea

Rrugëtimit të gjatë të arbëresheve të Shoqatës Vorea dhe Qendrës Albania Excellencë, për të festuar vitin e Skënderbeut në Shqipëri iu bashkua dhe Albsig, pjesë e Kastrati Group. Shoqëria e Sigurimeve Albsig si mbështetëse e njerëzve të artit dhe të trashëgimisë historike e kulturore, ishte pjesë e aktivitetit të zhvilluar në nder të vitit të Skënderbeut, këtë herë ndryshe, në një rrugëtim “historik” nga data. 01- 06 Maj në Shqipëri, një udhëtim në vendet ku ka luftuar Gjergj Kastrioti Skënderbeu Heroi Kombëtar, nga Kalaja e Petrelës, në fushën e Domosdovës, në fushën e betejës së Vajkalit, deri në Sinën e largët ku lindi Heroi ynë.



3.10 Albsig mbështet Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, shërbimin e Kardiologjisë

Në kuadër të marrëdhënieve të mira të bashkëpunimit, Spitali universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë, përmes një shkrese zyrtare i ka kërkuar shoqërisë së sigurimeve Albsig pjesë e Kastrati Group mbështetje në fushën e sponsorizimit për blerjen e disa aparatave të shërbimit të Kardiologjisë.

Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë dhe vlefshmerisë së aparatave të cilat ishin emergjente për jetën e pacienteve të këtij spitali, Albsig pjesë e Kastrati group beri të mundur mbështetjen e këtij donacioni për nevojat e popullatës.

Albsig si promotore e nismave të tilla ka mbështetur projekte të ndryshme në këtë drejtim nëpër të gjithë vendin. Tashmë një numër shumë i madh pacientesh pranë Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi” do të mund të marrin shërbimet e duhura dhe cilësore falë paisjeve të reja të repartit të kardiologjisë. Albsig pjesë e Kastrati group është mbështetësja kryesore e cila bëri të mundur që përmes donacioneve të saj të bëjë të mundur pajisjen me aparate ritmi dhe aparate tensioni të specifikuara dhe bashkëkohore si dhe paisjet të tjera plotësuese. Aparaturat e blera do ju vijnë në ndihmë qindra pacienteve që kanë problem kardiologjike.



3.11 Albsig mbështet teatrin “Migjeni”.

Albsig si promotore e vlerave artistike e kulturore ndër vite, fundvitin që mbyllëm ka mbështetur vënien në skenë të dramës “Jugori” me regji të Dino Mustafiq dhënë në teatrin “Migjeni” në Shkodër me 21 Dhjetor të vitit 2018.

Përgjegjësia sociale, promovimi i vlerave kulturore të vendit, të njerëzve të shquar të artit dhe mbështetja për ata që kanë bërë histori një art dhe kulturë, vazhdon të mbetet një nga parimet kryesore të Albsig. Pak ditë përpara kësaj dramë që flet për një të huaj që shkon në një vend tjetër duke prekur kryesisht temën e emigrimit, kryefjalë e vendeve të Ballkanit mes të cilave edhe Shqipëria regjisori Mustafiq shprehet se Europa sot është e shqetësuar për emigrantët dhe shumë paragjyime që lidhen me to

“Autori Fasbinder ka qënë një revolucionar i vitit 67 të shekullit të kaluar. Pjësja bën fjalë për emigrantët që kanë ikur nga vendi dhe punojnë nëpër Europë.

Këto probleme janë të dukshme edhe sot. Në Europë ka shumë paragjyime për jugorët, stereotipe dhe ksenofobi. Kjo shfaqet në mënyrë teatrale gërmon, dhe është aq prezente dhe sot falë emocioneve të dhuruara për publikun Për drejtoreshën e teatrit dhe aktorët shfaqja “Jugori” është një revolucion për teatrin “Migjeni” dhe mbështetja e bërë nga Albsig është vlerësuar nga të gjithë.

3.12 Albsig mbështet koncertin simfonik “Ndërmendje”

Albsig sponsor mbështetës i koncertit madhështor “Ndërmendje” projekt I realizuar nga fondacioni “ARTE”. Event i me shumë surpriza dhe risi në edicionin e tij të dytë është kthyer në një traditë në Shkodër sepse mbledh të gjithë solistët më të njohur që bashkohen orkestrën simfonike të këtij qyteti.

Projekti i këtij koncerti i mbajtur gjithmonë në vigjilje të festave të fundvitit pasi bën të mundur mbledhjen e gjithë solistëve të shquar brenda dhe jashtë vendit. “Ndërmendje”, një spekalël ku gjithçka luhet dhe përformohet live me instrumentiste virtuoz.

E vecanta e koncertit të këtij fund viti ishte sepse për herë të parë morën pjesë solistët me famë ndërkombëtare si Cecilia Laca Jose Maria, Gallardo del Rey, etj. Karriera e të cilëve është shpalosur në sallat më të rëndësishme botërore.



4.Politikat e monitorimit, administrimit dhe kontrollit të rrezikut të shoqërisë

Kevin W. Knight, ' Menaxhimi i riskut është një udhëtim ... Jo një destinacion' *.

Ndërsa vazhdojmë të përshtatem në një mjedis shumë të paqëndrueshëm, bizneset po bëhen më proaktive në lidhje me menaxhimin e riskut.

Albsig sh.a. njeh kufizimet e proceseve të "veta" dhe "të ndara" të menaxhimit të riskut dhe është proaktiv në integrimin e menaxhimit të riskut në vendimmarrje, proceset kryesore të biznesit dhe kulturën e përgjithshme të shoqërisë.

4.1 Menaxhimi i riskut

"Menaxhimi i administrimit të riskut është një proces i ndikuar nga drejtuesit e njësisë, menaxherët dhe pjesa tjetër e stafit, i projektuar për të identifikuar ngjarjet e mundshme që mund të kenë impakt në shoqëri si dhe menaxhuar riskun për ta mbajtur brenda kufijve të oreksit për arritjen e objektivave të shoqërisë" "

Menaxherët e riskut janë të lirë të fillojnë udhëtimin e tyre në çdo pikë, megjithatë mendojmë se vlerësimi i objektivave strategjike mund të konsiderohet një pikënisje e mirë. Arsyeja pse besojmë se kjo është një pikënisje e mire, sepse është relativisht e thjeshtë për t'u zbatuar dhe ka një impakt të menjëhershëm dhe të rëndësishëm në vendimmarrjen e menaxhimit të lartë. Gjithsesi, menaxherët e riskut duhet të fillojnë një diskutim me palët aktore kryesore të tyre për t'u përpjekur të kuptojnë se cilat janë pritjet e tyre nga menaxhimi i riskut.

Është e rëndësishme të kuptohet se çfarë është oreksi i vërtetë i tyre për ndryshim.

Menaxhimi i riskut është në fund të fundit për ndryshimin e kulturës së shoqërisë për të pranuar riskun dhe për të lehtësuar diskutimin e riskut gjatë kryerjes së aktiviteteve të biznesit ose marrjes së ndonjë vendimi strategjik, investimi ose projekti. Kështu bëhet e mundur kontrolli i udhëzimeve ose standardeve të menaxhimit të risqeve specifike.Strategjia e Menaxhimit jep një qasje gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar, për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar riskun.

Strategjia e Menaxhimit synon të ndërtojë dhe të nxisë zhvillimin duke u bazuar në rishikime të rregullta dhe procese të përditësimit të vlerësimeve.

Menaxhimi i riskut është një proces i vazhdueshëm, që është përdorur në zbatimin e strategjisë së biznesit dhe lejon për një kuptim të duhur të natyrës dhe rëndësisë së risqeve, ndaj të cilave biznesi është i ekspozuar, duke përfshirë edhe ndjeshmërinë ndaj këtyre risqeve dhe aftësinë e tij për të zbutur ato.

Strategjia është ndërtuar dhe mbështetur në disa parime thelbësore që përcakton dhe menaxhimin e riskut në drejtimet si vijon:

Menaxhimi i Riskut krijon dhe mbron vlerat;

Menaxhimi i Riskut është pjesë integrale e proceseve të shoqërisë;

Menaxhimi i Riskut është pjesë e vendimmarrjes;

Menaxhimi i Riskut i adresohet pasigurisë;

Menaxhimi i Riskut është sistematik, i strukturuar dhe në kohë;

Menaxhimi i Riskut bazohet në informacionin më të saktë të mundshëm;

Menaxhimi i Riskut merr në konsideratë faktorët njerëzor dhe kulturor;

Menaxhimi i Riskut është transparent dhe përfshirës;

Menaxhimi i Riskut është dinamik, interaktiv dhe reagues ndaj ndryshimeve; dhe

Menaxhimi i Riskut lehtëson përmirësimin e vazhdueshëm të shoqërisë.

Po kështu konsiderimi i palëve të interesuara në kuadrin e zgjedhur të menaxhimit të riskut / standardit

E rëndësishme të arrihet një qasje e koordinuar dhe e integruar e menaxhimit të riskut në një gjuhë të përbashkët të riskut, që kuptohet në të gjithë biznesin.

4.2 Kuadri i Administrimit të Riskut / Struktura qeverisëse

Shoqëria Albsig Sh.a. mbikëqyret dhe kontrollohet nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve dhe Këshilli Mbikëqyrës. Kompetencat e këtyre organeve drejtuese përcaktohen në Statutin e Shoqërisë dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore. Këshilli Mbikëqyrës është në fund përgjegjës për të siguruar efektivitetin e sistemit të menaxhimit të riskut, përcaktimin e oreksit të riskut dhe kufizimet e përgjithshme të tolerancës së riskut, si dhe miratimin e strategjive kryesore të menaxhimit të riskut dhe politikave përkatëse. Komiteti i Administrimit të riskut luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin sa më mirë të riskut nëpërmjet departamenteve.

Shoqëria Albsig sh.a. është një shoqëri që prej disa vitesh ka vendosur një standart në shërbim të përmbushjes së menaxhimit të riskut në lidhje me riskun strategjik.

Referuar këtij standarti në muajin Dhjetor të cdo viti shoqëria Albsig sh.a. vjen me përpilimin dhe miratimin e planeve për vitin pasardhës.

Në Muajin Dhjetor të vitit 2018 u miratuan nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë planet e vijueshmërisë për vitin 2019 dhe konkretisht:

- Plani Ekonomiko Financiar
- Plani i Menaxhimit të Riskut
- Plani i Auditi të Brendshëm
- Plani i Risigurimeve

Të gjithë këto plane skedulojnë orientimn e shoqërisë për vitin 2019.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm të shoqërisë dhe Komiteti i Menaxhimit të Riskut luajnë një rol të rëndësishëm në funksionin dhe në menaxhimin sa më të mirë të shoqërisë.

Departamenti i Menaxhimit të Riskut dhe IT që përfshin Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut si dhe Drejtorinë e IT ka kontributin kryesor në evidentimin dhe analizën në punën e përditshme rutinore duke dhënë kontributin kryesor në problemetikat e përditshme

Komiteti i Administrimit të Riskut po luan një rol në vendosjen e standarteve në shoqëri në lidhje me riskun. Departamenti i Menaxhimit të Riskut dhe IT ka përmbushur një sërë detyrash për të menaxhuar riskun sa më mirë dhe për të siguruar një shpërndarje të tij në rast moseliminimi.

Kështu u miratuan gjatë këtij viti "Plani i vazhdueshmërisë së biznesit dhe i katastrofave", i cili luan një rol të rëndësishëm në pasigurinë në ditët e sotme si riskun e mosvazhdimësisë së biznesit, risku kibernetik, risku i katastrofave etj.

Po kështu në ndërtim të standarteve të shoqërisë u përpiluan politika të menaxhimit të riskut të IT apo ndryshe Manuali i IT, i cili realizon mundësinë për të kryer minimizimin e riskut operacional riskut të programeve, softeve, sistemeve si dhe procedurë e qartë të ndjekur në rast ndodhje.

Kështu kompetencat dhe detyrat e përdoruesve në sistem dalin më qartë dhe dokumentohen dhe nivelet e hierarkisë në sisteme dhe programe sipas pozicionit të punës dhe përgjegjësisë të gjithësecilit.

Procese dhe mjete të përshtatshme, përfshi edhe modelet, kur është e mundur, për përcaktimin, vlerësimin, mbikëqyrjen, administrimin dhe raportimin e risqeve, si edhe planet e përballimit të situatave të paparashikuara, apo planet e vijueshmërisë së veprimtarisë dhe administrimit të krizës; Procedura, për shqyrtimin rregullisht të sistemit të administrimit të riskut dhe të elementëve përbërës të tij, për të kryer në kohë përshtatjet dhe përmirësimet e nevojshme.

Komiteti i Administrimit të Riskut ka autoritetin dhe përgjegjësinë që të drejtojë dhe koordinojë të gjitha funksionet e administrimit dhe vlerësimit të riskut.

Komiteti i Administrimit të Riskut është përgjegjës për rishikimin e politikave të administrimit të riskut të shoqërisë dhe kapacitetin e limiteve të riskut, si dhe për monitorimin e tolerancës ndaj riskut, rishikimin e linjave të bizneseve me risk të lartë dhe ekspozimin ndaj tyre.

Shoqëria Albsig Sh.a gjatë vitit 2018 u fokusua në një përforsim të strukturës së administrimit të riskut për të mbështetur objektivat për administrimin më efektiv të riskut.

Komiteti i Administrimit të Riskut pas certifikimit të cdo viti financiar të raporteve financiare nga Auditori i jashtëm mblidhet e analizon problemet e ardhura nga DMRI si dhe Auditori i brendshëm dhe pas shqyrtimit të tyre del me rekomandime konkrete në nivelin makro të shoqërisë për të forcuar menaxhimin e riskut në marrjen e vendimeve sa më të mira për shoqërinë.

Përbërja e Komitetit të Administrimit të Riskut ndryshon nga shoqëria në shoqëri dhe duhet të jetë i mjaftueshëm përfaqësues për të siguruar që pikëpamjet e ndryshme të riskut janë konsideruar.

Komiteti i Administrimit të Riskut bashkon funksionet mbështetëse (financa, risku, siguria, kontrolli i brendshëm) dhe njësitë e biznesit (operacionet, marrja në sigurim, marketingu).

Komiteti i Administrimit të Riskut merret me çështjet që lidhen me metodologjinë e menaxhimit të riskut ose mund të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes (investimet, projektet dhe aktivitetet e tjera me risk të lartë) ose të dyja.

Komiteti i Administrimit të Riskut mblidhet në baza të rregullta (katërmujore) si dhe me kërkesë të Kryetarit të Komisionit të Administrimit të Riskut nëse ka çështje që kërkojnë analizë urgjente të riskut.

Komiteti i Administrimit të Riskut kryen raportime periodike mbi risqet e evidentuara nga njësitë e biznesit. Vlerësimi i risqeve kryesore kryhet nga Drejtorja e Menaxhimit të Riskut në Departamentin e Menaxhimit të Riskut dhe IT dhe shqyrtohen me pas konkludohet dhe miratohen planet e vijueshmërisë të cilat miratohen nga Komiteti i Administrimit të Riskut. Për vlerësimin dhe klasifikimin e risqeve përdoret vlerësimi i frekuencës dhe ashpërsia e riskut. Kur risqet kanë frekuencë dhe ashpërsi të ulët administrimi bazohet tek proceset dhe kontrollet e përditshme sipas manualeve të miratuara. Risqet që kanë frekuencë dhe ashpërsi të lartë kanë kontroll më të rreptë, si marrja në sigurim.etj

Five Steps of the Digital Risk Management Process

4.1 Identifikimi dhe kategorizimi i risqeve

1 Identify the Risk

Pasi objektivat strategjike të jenë ndarë në pjesë më taktike dhe më të menaxhueshme, menaxherët e riskut duhet të përdorin dokumentin e strategjisë, modelin financiar, planin e biznesit ose modelin e buxhetit për të përcaktuar supozimet kryesore të bëra nga menaxhimi i lartë.

Shumica e supozimeve lidhen me një formë të pasigurisë dhe kështu domosdoshmërisht kërkohet analizë e riskut.

Analiza e riskut ndihmon në vendosjen e supozimeve joreale të menaxhimit nën dritën e vëmendjes.

Kriteret e përbashkëta për zgjedhjen e supozimeve të menaxhimit për analizë të mëtejshme të riskut përfshijnë:

- Supozimi lidhet me pasiguri të lartë.
- Ndikimi i supozimit reflektohet siç duhet në modelin financiar
- Organizata ka statistika ose ekspertë të besueshëm për të përcaktuar gamën e mundshme të vlerave dhe shpërndarjen e mundshme të vlerave.
- Ekzistojnë burime të besueshme të informacionit të jashtëm për të përcaktuar gamën e mundshme të vlerave dhe shpërndarjen e mundshme të vlerave.

Njëkohësisht, menaxherët e riskut duhet të kryejnë një vlerësim klasik të riskut për të përcaktuar nëse të gjitha risqet e rëndësishme janë kapur në analizën e supozimeve të menaxhimit. Vlerësimi i riskut duhet të përfshijë një rishikim të raporteve ekzistuese të menaxhimit dhe raporteve financiare, hulumtimit të industrisë, raporteve të auditorëve, sigurimeve dhe inspektimeve të palëve të treta, si dhe intervista me punonjësit kryesorë.

Në fund të këtij hapi, drejtuesit e riskut, menaxherët e riskut bashkërendojnë procesin, auditoin e brendshëm dhe shfrytëzojnë burimet e informacionit të brendshëm dhe të jashtëm për të përcaktuar vargjet e vlerave të mundshme dhe formën e tyre të mundshme të shpërndarjes

Në Planin e Menaxhimit të Riskut identifikimi i risqeve është komponenti kryesor dhe ka për qëllim identifikimin e të gjitha risqeve të rëndësishme me të cilat përballlet shoqëria.

Shoqëria fokusohet tek risqet kryesore, të cilat pengojnë arritjen e objektivave strategjike.

Këto risqe janë pjesë e procesit të administrimit të riskut.

Pjesë e procesit të administrimit të riskut janë dhe risqet që lidhen me veprimtarinë e përditshme.

Shoqëria ka identifikuar si risqe kryesore ku dhe ka orientuar skenarët e stresit si më poshtë:

- Risku i sigurimit
- Risku i kreditit
- Risku i tregut
- Risku i likuiditetit
- Risku operacional
- Risku strategjik

Këto janë risqet kryesore që mund të kërcënojnë objektivat strategjike të shoqërisë, por ka dhe risqe të tjera si:

- Risku i këmbimit të monedhës së huaj
- Risku reputacional
- Risku i cmimeve të sigurimit të detyrueshëm motorik, në vecanti TPL.

Risqet e pranishme në shoqëri janë të përfshira në një prej kategorive të identifikuara më poshtë:

5 Monitor and Review the Risk

4.4 Analiza e riskut

Hapi i ardhshëm përfshin kryerjen e një analize për të vlerësuar efektin e pasigurisë në objektivat strategjike të shoqërisë. Modelimi i riskut mund të kryhet në një model risku të dedikuar ose brenda modelit ekzistues financiar.

Kur modelon risqet është me rëndësi të konsiderosh lidhjet mes supozimeve të ndryshme. Një nga mjetet e dobishme për një analizë të thellë të riskut dhe identifikimin e ndërvarësive është përdorimi i hartave të zonave të ndryshme të riskut ku shoqëria vendos të gjithë komponentet dhe me identifikim të risqeve dhe prioriteteve të tyre përcaktohet harta e riskut e cila përcakton zonat e riskut më të lartë në hartën e riskut dhe i monitoron duke përdorur vendimarrje të lidhura me teknikat për ta eliminuar, monitoruar, transferuar apo pranuar riskun sipas identifikimit të impaktit të tyre në shoqëri. Një analizë e tillë ndihmon në përcaktimin e shkaqeve dhe pasojave të çdo risku, përmirëson modelimin e tyre, si dhe identifikimin e korrelacioneve midis supozimeve dhe ngjarjeve të ndryshme të menaxhimit.

Rezultati i analizës së riskut ndihmon në përcaktimin e probabilitetit të përshtatur ndaj riskut për arritjen e objektivave strategjike dhe risqet kyçe që mund të ndikojnë negativisht ose pozitivisht në arritjen e këtyre objektivave strategjike. Menaxherët e riskut duhet të diskutojnë rezultatet e analizës së riskut me ekipin ekzekutiv për të parë nëse rezultatet janë të arsyeshme, reale dhe vepruese. Nëse me të vërtetë rezultatet e analizës së riskut janë të rëndësishme, atëherë menaxhmenti me ndihmën e menaxherit të riskut mund të ketë nevojë të:

- Rishikohen supozimet e përdorura në strategji.
- Merret parasysh ndarja e disa prej risqeve me palët e treta duke përdorur mekanizmat e mbrojtjes, ato të jashtëm ose të sigurimit.
- Konsiderohet reduktimi i riskut duke adoptuar qasje alternative për arritjen e objektivit të njëjtë ose zbatimin e masave të përshtatshme të kontrollit të riskut.
- Pranohet risku dhe zhvillohet një plan i vazhdueshmërisë / planit të rikuperimit të fatkeqësive për të minimizuar ndikimin e risqeve nëse ato ndodhin.
- Ose, ndoshta, ndryshon strategjia krejtësisht.

Bazuar në rezultatet e analizës së riskut mund të kërkohet që menaxhimi i lartë të rishikojë ose përditësojë të gjithë strategjinë ose vetëm elementët e saj. Kjo është një nga arsyet pse rekomandohet shumë për të kryer analizën e riskut përpara se të finalizohet strategjia.

Në një fazë të mëvonshme, menaxheri i riskut duhet të punojë me auditimin e brendshëm për të përcaktuar nëse rreziqet e identifikuara gjatë analizës së riskut janë në fakt të kontrolluara dhe zbatohet zbutja e riskut të pranuar.

General risk information		Original probabilities and impacts				Pre-Mitigation				Po			
Risk Name	Open...	Risk/Issue	Threat/O...	Prob...	Sche...	Cost	Quality	Risk Assigned To	Pro...	Imp...	Scor...	Score	Pro...
1 Delay in financing	Opened	Risk	Threat	5	1	5	1	Assigned to 2 project	5	5	25		4
2 Failed performance test	Opened	Risk	Threat	2	2	1	1	Software Developer	5	2	10		2
3 Unit test found serious bugs	Opened	Risk	Threat	2	1	5	1	Software Developer	2	5	10		2
4 Requirement changes	Opened	Risk	Threat	1	5	1	1	Assigned to 2 project	2	4	8		2
5 Delay in getting updated requirements	Opened	Risk	Threat	2	3	3	1	Product Design	2	3	6		2
6 Calculation algorithm has limitations	Opened	Risk	Threat	2	2	1	1	Assigned to 2 project	2	3	6		2
7 Competition on the market place	Opened	Risk	Threat	2	1	1	2	Assigned to 2 project	2	2	4		2
8 Delay in developing software documentation	Opened	Risk	Threat	3	1	1	1	Implementation and De	3	2	6		3
9 Selected software tools are not suitable for the project	Opened	Risk	Threat	1	1	3	1	Software Developer	1	4	4		1
10 Delay in getting response from the client	Opened	Risk	Threat	1	3	3	1	Product Design	1	4	4		1
11 Failed integration with third party software	Opened	Risk	Threat	1	1	3	1	Software Developer	1	4	4		1
12 QA process takes longer	Opened	Risk	Threat	1	1	1	4	Implementation and De	1	4	4		1
13 Key software developer left a team	Opened	Risk	Threat	1	3	1	1	Software Developer	1	3	3		1
14 Failed software installation and configuration	Opened	Risk	Threat	1	1	1	3	Implementation and De	1	3	3		1

ID	DESC	OWNER	PRO (1-5)	IMPACT (1-5)	CRI (1-15)	PRIORITY	MITIGATION COST	IMPACT COST
Select 1	ALL SYSTEMS CRASHES IN ONE DAY	IT DEPARTMENT	4	5	20		€ 80,000.00	€ 190,000.00
Select 2	BULGARIA IN THE OFFICE	STOCK	4	5	20		€ 245,230.00	€ 2,500,000.00
Select 3	CONTRACTOR BLOPS	INVENTORY DEPT	1	2	2		€ 2,500.00	€ 5,000.00
Select 4	DEVELOPER NOT AVAILABLE	IT DEPARTMENT	3	5	15		€ 120,000.00	€ 2,500,000.00
Select 5	NOTHING TO PRODUCE FOR 2013	STOCK	3	5	15		€ 35,000.00	€ 10,000.00
Select 6	PLANE CRASH KILLS HD	GENERAL	4	5	20		€ 200,000,000.00	€ 25,000.00
Select 7	NATURAL DISASTER HAPPENS	GENERAL	1	5	5		€ 250,000.00	€ 4,000,000.00
Select 8	COMPETITORS STEAL COMPANY FORMULAR	MANAGEMENT	3	5	15		€ 20,000.00	€ 230,000.00
Select 9	HACKERS CLOSE OUR SERVERS DOWN	IT DEPARTMENT	4	5	20		€ 750,345.11	€ 5,300,000.00

i) Risku i Kreditit

Vlerësimi mund të përfshijë vlerësimin, listat e kontrollit, takime pune për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të mjedisit të riskut operacional e më gjerë.

Risku i kreditit i referohet riskut të mospagimit të detyrimeve kontraktuale të cilat rezultojnë në humbje financiare të shoqërisë. Në rrjedhën normale të aktivitetit të saj, kur pranohen primet fondet investohen për të paguar detyrimet e ardhshme ndaj të siguarve. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut nga fondet e mbajtura, depozitat dhe risiguruesit. Shoqëria ka vendosur procedura të brendshme nga ku risiguruesit mund të kenë klasifikime BB ose norma më të larta dhe risku është i monitoruar nga personeli i risigurimeve. Shoqëria administron ekspozimin e saj ndaj riskut të kredisë duke monitoruar zbulimin ndaj instrumenteve të borxhit dhe depozitave.

	2018				2017			
	Primet e ceduara		Primet e ceduara		Primet e ceduara		Primet e ceduara	
	'000 Lekë	'000 Lekë	'000 Lek	'000 Lekë	'000 Lekë	% ndaj totalit	'000 Lekë	% ndaj totalit
Norma								
AA	6,574	4.77%	2,673	7.24%	963	0.59%	531	0.59%
A+	55,527	40.32%	14,064	38.11%	118,330	71.90%	66,264	73.00%
A	27,332	19.85%	12,370	33.52%	21,912	13.31%	11,085	12.21%
A-	12,218	8.87%	3,116	8.44%	11,660	7.09%	6,431	7.09%
AA-	36,050	26.18%	4,683	12.69%	11,704	7.11%	6,456	7.11%
BB	-	-	-	-	-	-	-	-
Pa normë	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali	137,701	100.00%	36,906	100.00%	164,569	100.00%	90,767	100.00%

Risku i kreditit lidhet kryesisht me risigurimin, duke qenë se shoqëria, pavarësisht cedimit të risqeve tek risiguruesi ka detyrimin ndaj klientëve edhe nëse risiguruesit falimentojnë.

ii) Risku i Tregut

Risku i tregut për shoqërinë lidhet kryesisht me faktorë të tregut financiar, si normat e interesit dhe kurset e këmbimit, apo faktorë të jashtëm, si ecuria ekonomike, si dhe humbje nga portofoli i investimeve.

iii) Risku i normës së interesit

Risku i normave të interesit është i ndikuar nga risku i luhatjeve të vlerave të instrumenteve financiare si pasojë e ndryshimeve në tregun e normave të interesit dhe risku që maturitetet e interesave në lidhje me aktivet të ndryshojë nga maturiteti i interesave të lidhura me detyrimet e përdorura për këto aktive. Kohëzgjatja për të cilën është fiksuar norma e interesit mbi një instrument financiar tregon se ndaj çfarë niveli risku të normave të interesit është ekspozuar. Aktivet dhe pasivet e shoqërisë kanë norma interesi të tregut.

Shoqëria mban një shumë jo të konsiderueshme të detyrimeve mbartëse dhe risku i shaktimit të kostove të rëndësishme që vijnë si shkak i rritjes në normat e interesit nuk është domethënës. Në krahun tjetër, aktivet interes mbartëse kanë normë interesi fikse.

iv) Risku i këmbimit të monedhës së huaj

Primet janë shprehur në tre valuta kryesore (LEKË, USD dhe EURO). Flukset monetare nga të ardhurat nga primet janë burimi kryesor i fondeve për depozitat me afat në valutë të huaj. Risku i këmbimit të monedhës së huaj lind nga lëvizjet në kurset e këmbimit të monedhës së huaj. Ekspozimi ndaj këtij risku kryesisht lind gjatë një periudhe në të cilën shoqëria ka një pozicion të hapur si në bilanc dhe jashtë bilancit dhe/ose me kursin aktual ose të ardhshëm të tregut. Është kryer analizë sasiore e rrezikut valutor të shoqërisë më 31 dhjetor 2018.

Ndikimi i luhatjeve të kurseve të këmbimit është reflektuar për vitin e mbyllur 2018.

v) Risku i risigurimit

Shoqëria çedon rrezik sigurimi në limitet e ekspozimit të humbjeve të nënshkruara nën marrëveshje të ndryshme që mbulojnë linja biznesi të përcaktuara, mbi bashkësigurimin, çdo vit me terma të rinovueshëm dhe tejkallim i bazave të humbjes. Këto marrëveshje risigurimi shpërndajnë riskun dhe minimizojnë efektin e humbjes. Sipas termave të marrëveshjes së risigurimit, risiguroesi bie dakord të rimburojë shumën e ceduar në ngjarjen kur paguhet dëmi. Gjithsesi shoqëria mbetet përgjegjëse ndaj policëmbajtësve të saj duke respektuar sigurimin e ceduar nëse ndonjë risiguroes dështon të plotësojë detyrimet që merr përsipër.

Kur përzgjidhet një risiguroes shoqëria merr në konsideratë sigurinë e tyre relative. Siguria e risiguroesit është vlerësuar nga informacioni i normimit publik.

vi) Risku Operacional

Risku operacional shfaqet nga problemet në performancën e funksioneve ose proceseve të biznesit. Ekspozimi ndaj këtij risku mund të lindë nga mangësitë ose defektet në kontrollat e brendshme ose proceset, defektet në teknologji, gabimet njerëzore ose pandershmëria dhe katastrofat natyrore.

- Përdorimi më efikasitet i sistemit të shitjes, administrimit dhe dëmeve ka minimizuar shumë risqe duke bërë të mundur një harmonim më të mirë midis kontrollit dhe raportimit.

- Rëndësi e madhe është dhënë pagesës së dëmeve, duke e konsideruar një marketing për shoqërinë. Paga e dëmit në një periudhë të shkurtër është një praktikë, e cila ndiqet deri në lajmërimin e klientit që vlera e dëmit të rënë dakord nga klienti ka kaluar në llogarinë e tyre dhe ka ndikuar në performancën e shoqërisë. Shoqëria për vitin 2018 në tërë historikun e saj ka kohën më të ulët të trajtimit të dëmit deri në pagesën e tij, si dhe në fundvitin 2018 numrin më të ulët të dëmeve të papaguara.

- Analizat aktuariale ndikojnë në aplikimin e metodave më të mira aktuariale për llogaritjen e provigjoneve të dëmeve (IBNR) dhe për kontrole më të forta mbi të dhënat nga Aktuari, sidomos të dëmeve shëndetësore të TPL, të cilat kanë dhe luhatje në vlerësime gjatë trajtimit të tyre. Për këtë Departamenti i Dëmeve bashkëpunon me Departamentin Juridik dhe Departamentin e Menaxhimit të Riskut dhe IT për marrjen e informacionit të plotë dhe në kohë për të gjitha rastet e ndodhura të dëmeve për tu raportuar saktë për efekt të provigjoneve teknike të dëmeve si dhe azhurnimi i dëmeve në proces gjyqësor me vendimet e gjykatave në periudhat që raportohen dhe në zbatim të "Procedura për trajtimin e dëmeve sipas statuseve të tyre dhe rakordimi ndërmjet departamenteve përkatëse".

- Testimi i provigjionimit të dëmeve është bërë nëpërmjet analizës RUN-OFF të dëmeve. Kjo analizë është bërë për dëmet e ndodhura dhe të raportuara (RBNS) në shoqëri dhe për dëmet e ndodhura dhe nuk janë të raportuara (IBNR). Teste për vlerësimin e provigjoneve të dëmeve në 31.12.2017 për sigurimin e detyrueshëm motorik TPL, Karton jeshil, Kufitare dhe Kasko janë bërë në mënyrë të vazhdueshme në periudhat në vazhdim duke marrë rezultate pozitive.

- Megjithatë rezultate pozitive janë marrë kryesisht për IBNR, që për rredhojë sjell rezultat pozitiv të totalit duke ndryshuar ndjeshëm edhe nga vitet paraardhëse. Si më poshtë po japim një rezultat për MTPL, Kartonin jeshil dhe Kaskon që zënë dhe peshën kryesore në provigjonet e dëmeve total.

Departamenti i Burimeve njerëzore të shoqërisë bën një punë efektive në përzgjedhjen e profesionistëve në sigurime, agjentëve me një cilësi sa më të mirë në shërbimin ndaj klientit duke iu referuar gjithmonë misionit kryesor të shoqërisë.

Klienti në vizionin e shoqërisë sonë është i pari dhe shërbimi ndaj tij duhet të marrë një vlerë, e cila na bën konkures në treg. Politikat e komunikimit dhe ato të motivimit të punonjësve luajnë një rol të rëndësishëm në mirëfunksionimin e burimeve njerëzore të shoqërisë Albsig sh.a.

vii) Risku i Likuiditetit

Norma e likuiditetit është raporti midis aktiveve likuide të shoqërisë dhe detyrimeve të maturuara për pagesë si dhe detyrimeve që maturohen së shpejti.

Shoqëria e sigurimit konsiderohet likuide në qoftë se rezultati i llogaritjes së normës së likuiditetit, referuar në nenin 6 të rregullores “Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit”, është më i lartë ose i barabartë me 1 (një).

Për qëllim të monitorimit të likuiditetit shoqëria bën monitorimin e fluksit të parasë në mënyrë periodike duke u bazuar në llogaritjet me bazë ditore të normës së likuiditetit.

viii) Risku Ligjor dhe Rregullator

Risiku ligjor dhe rregullator lidhet kryesisht me ndryshimin ligjor dhe rregullator.

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut rregullator si krijimi i provigjoneve të primit të pafituar për sigurimin e detyrueshëm motorik sipas primeve të rrezikut të përcaktuar nga AMF, pavarësisht cmimeve të zbatuara nga shoqëria.

Gjithashtu shoqëria duhet të ketë likuiditet për krijimin e rezerves monetare.

ix) Risku Strategjik

Risiku strategjik lidhet kryesisht me pozicionimin strategjik të shoqërisë në treg. Risqe strategjike për shoqërinë janë humbje e klientëve potencialë.

4.4 Oreksi i riskut dhe kufijtë e tolerancës së riskut të miratuara

Solvency II i referohet si oreksit të riskut dhe riskut të tolerancës. Pjesa në vijim përcakton udhëzime të përgjithshme në lidhje me riskun e oreksit dhe riskut të tolerancës që merren në konsideratë. Albsig do të përdorë termin “kapaciteti i riskut” që do të shihet si një funksion i fuqisë financiare dhe aftësisë së menaxhimit të riskut.

Oreksi i riskut mund të përkufizohet si artikulli i gatishmërisë për të marrë përsipër riskun, dhe duhet të fokusohet, të paktën, mbi risqet më materiale të biznesit.

Oreksi i riskut trajton qëndrimin e Këshillit Mbikëqyrës drejt risqeve më të rëndësishme me të cilat përballet biznesi. Kufijtë e tolerancës së përgjithshme të riskut mund të përcaktohen si kufizime të menaxhimit që imponon në vetvete marrjen e këtyre risqeve. Kjo mund të përfshijë kufizime të detajuara të mbështetura nga proceset e monitorimit dhe udhëzon për vendime të marra ditë pas dite të bëra në përputhje me metrikat e oreksit të riskut të përgjithshëm. Çdo kategorizim i riskut duhet të trajtohet nga kombinimi i oreksit të riskut dhe tolerancës.

Është e rëndësishme që orekset e riskut dhe tolerancat të jenë të komunikueshme në mënyrë të qartë për të gjithë menaxherët dhe stafin përkatës në të gjitha nivelet.

Risiku strategjik shfaqet nga paaftësia e një shoqërie për të zbatuar planet e duhura të biznesit, strategjitë, vendimmarrjet, shpërndarjen e burimeve si dhe paaftësia e tij për tu përshtatur me ndryshimet në mjedisin e tij të biznesit.

Duhet të vlerësohen vetëm risqet kryesore në një aktivitet. Për shembull, në një aktivitet të marrjes në sigurim, risku i sigurimit është risku kryesor, por risku i kreditit nuk është i tillë po që se nuk ka kushte kredie për primet, të cilat kanë peshë. Anasjelltas, ndërsa në risigurim nuk ka risk sigurimi, risku i kreditit është një risk kryesor. Risku operacional është i pranishëm në shumicën e aktiviteteve dhe risku strategjik mund të jetë i pranishëm në një aktivitet, në qoftë se shoqëria ka hartuar plane strategjike për aktivitetin, dështimi i të cilave do të dëmtonte mirëqenien e shoqërisë.

Është detyra e inspektorit që të zbatojë gjykimin e shëndoshë, për të informuar dhe për të vendosur se cilat risqe i përkasin një aktiviteti dhe deri në çfarë mase i përkasin. Risqet do të kategorizohen si të ulët, mesatarë ose të lartë.

Përkufizimet për kategorizimin e risqeve janë:

- I ulët. Risku i pranishëm i ulët ekziston kur, ekspozimi dhe pasiguria nga ngjarjet e ardhshme potenciale, ka një probabilitet më të ulët se mesatarja për të pasur ndikim negativ mbi kapitalin ose fitimet e një shoqërie.
- Mesatar. Risku i pranishëm mesatar ekziston kur, ekspozimi dhe pasiguria nga ngjarjet e ardhshme potenciale, ka një probabilitet mesatar për të pasur ndikim negativ mbi kapitalin ose fitimet e një shoqërie.
- I lartë. Risku i pranishëm i lartë ekziston kur, ekspozimi dhe pasiguria nga ngjarjet e ardhshme potenciale, ka një probabilitet më të lartë se mesatarja për të pasur ndikim negativ mbi kapitalin ose fitimet e një shoqërie.

Koncepti i ‘probabilitetit mesatar’ është subjektiv. Nuk ka ndonjë shkallë absolute me anë të së cilës të mund të matet risku. Vlerësimi i nivelit të riskut në një aktivitet kërkon ta njohësh dhe ta kuptosh mjaft thellë aktivitetin dhe të përdorësh gjykimin e shëndoshë, dhe të informuar mbi faktet që janë në dispozicion.



x) Risku i Sigurimit

Risku i Dizenjimit të Produktit dhe i Vendosjes së Çmimit

Risku i Marrjes në Sigurim dhe i Përgjegjësive

Shoqëria ka miratuar "Procedura dhe politika të brëndshme lidhur me verifikimin e përputhshmërisë me politikat e marrjes në sigurim dhe sistemet e tarifimit të tyre".

Këto politika janë në ndryshim të vazhdueshëm në përshtatje me tregun, rregullatorët për të vendosur një standart më të lartë në menaxhimin e risqeve në nivel shoqërie.

Shoqëria miraton urdhëra dhe procedura për nivelin e kompetencave të marrjes në sigurim të produkteve vullnetare për shumat e sigurimit. Kufizimet janë të vendosura nga sistemi i shitjes dhe administrimit.

Ky nivel kompetencash është gjithmonë i monitoruar dhe i ndryshueshëm në përshtatje me tregun, rregullatorët për të vendosur një standart më të lartë në menaxhimin e risqeve në nivel shoqërie.

Sistemi i shitjes dhe administrimit gjithmone është në zhvillim për një përshtatje sa më të mirë me qasjen ndaj produkteve për shitjen në sistem si dhe qasje për një administrim sa më të mirë të tyre.

Aktiviteti i marrjes në sigurim në shoqëri mbikëqyret nga menaxher të nivelit të lartë, por aktiviteti i marrjes në sigurim është i ndarë në njësi të vecanta operative që mbikëqyret nga menaxherët sipas linjave të vecanta të sigurimit. Në marrjen në sigurim në shoqëri përgjegjësitë e biznesit që përmbajnë risk të lartë janë të mbikëqyrura nga menaxherë me nivel të lartë profesional.

Shoqëria gjithmone investon në përmirësimin e Sistemit të shitjes dhe administrimit të kontratave të sigurimit duke e parë me prioritet dhe rëndësinë që ka mirëfunksionimi i këtij sistemi për riskun operacional kjo bën që të monitorohet duke vendosur procedura të forta të shitjes së kontratave të sigurimit si më poshtë:

Për monitorimin e risqeve të marrjes në sigurim një rëndësi ka dhe kontrolli i risqeve ditore për marrjen në sigurim i cili monitorohet në mënyrë ditore dhe ndiqet deri në eliminimin e tij në lidhje me qasjen e procesit e marrjes në sigurim.

Rregjistrat e riskut dhe hartat e nxehtësisë së riskut ndihmojnë për një monitorim sa më të mirë të riskut në nivel makro të shoqërisë. Kjo bën të mundur ndërhyrjen në kohë në zonat e evidentuara me risk të lartë apo më të nxehta dhe monitorimin e tyre sipas prioriteteve dhe riskut të lartë që kanë.

Propozim të primeve dhe tarifave të produkteve nga sistemi duke mos lejuar shitjen nën këto prime pa marrë miratimin e personave përgjegjës. (Nivel kompetencash e shkruar dhe bllokuese në sistemin e shitjes)

Kufizime për shumat e sigurimit tek policat vullnetare sipas kompetencave. (Nivel kompetencash)

Kufizim në shitje të llojit të kontratave të sigurimit sipas userave të shitjes.

Parametrizim të policës së sigurimit sipas kompetencave etj.

Shitja në kohë reale pothuajse e të gjithë produkteve.

Procedurë e fortë për anulimin, dublikimin dhe kthimin e kontratave të sigurimit etj.

Në strukturën organizative të shoqërisë ka menaxhim të mirë të njësisë të marrjes në sigurim sipas linjave të sigurimit dhe përfshirja e njësisë së administrimit të kontratave të sigurimit.

Njësia e administrimit të kontratave të sigurimit në cdo periudhë mujore raporton dhe në bashkëpunim me njësitë e marrjes në sigurim sipas linjave të sigurimit kryejnë një kontroll rigoroz të policave fizike për të qenë në përputhje me kushtet e marrjes në sigurim.

Kontratat e sigurimit fizike mbi 10% e Aftësisë Pagueve kontrollohen edhe pranë Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut dhe IT. Në momentin e marrjes së informacioneve shtesë për policat e sigurimit shoqëria bën rishikim të kufijve të marrjes në sigurim.

Gjithashtu nga personat përgjegjës kryhen kontrole ditore/periodike në kohë reale nëpërmjet sistemit të shitjes së policave, që policat e shitura të jenë në përputhje me kushtet e kontratave të sigurimit.

Kur identifikohet që ka mangësi ose gabime në plotësimin e policës së sigurimit, këto raste raportohen në personat përkatës për t'u rregulluar.

Përsa i përket rrezikut të marrjes në sigurim sistemi i shitjes ka një rol të rëndësishëm dhe një kontroll në nivele ku çdo punonjës apo përdorues ka limitet e veta deri në finalizimin e marrjes në sigurim. Për produktin kasko, garanci oferte, garanci kontrate etj me anë të sistemit të shitjes kontrollohen të gjithë agjentët të cilët kanë akses për të marrë në sigurim këto produkte dhe është përgjegjësi i këtyre produkteve që i monitoron dhe u miraton një vlerë më të madhe se e lejuara me anë të sistemit, tarifat preferenciale duke krijuar një historik të veprimeve deri në finalizimin përfundimtar të marrjes në sigurim.

Shoqëria Albsig ka gjithmonë në fokus përmirësimin e sistemit të shitjes dhe administrimit. Ky sistem është gjithmonë në ndryshim për tu përshtatur sa më mirë me nevojat e shoqërisë dhe me përdoruesit e tij.

Shumë përmirësime në lidhje me sistemin e shitjes dhe administrimit janë finalizuar dhe të tjera janë në proces për tu finalizuar në të ardhmen.

4.6 Toleranca dhe kufijtë e riskut

Toleranca ndaj riskut përcaktohet nga objektivat strategjike të shoqërisë. Objektivat strategjike të shoqërisë janë të lidhura kryesisht me objektivat e rritjes në treg, marzhet e synuara të fitimit dhe mbajtjen e një niveli kapitali mbi një marzh të caktuar. Në këto objektiva është përcaktuar si qëllimi i pozicionimit në treg në pjesmarrje, ashtu dhe në raport me cilësinë e shërbimit.

Matësit e nivelit të riskut që përdoren kryesisht janë kufijtë gjatë procesit të marrjes në sigurim, si për ekspozimet individuale ashtu dhe për ekspozimet agregate sipas linjave të sigurimit.

Shoqëria ka manual dhe procedura të hartuara për këtë qëllim. Shoqëria është në proces ndërtimi të një manuali të ri, i cili do të jetë një ndihmesë e madhe në të ardhmen.

Shoqëria zbaton marrëveshje risigurimi treaty, facultative dhe fronting në mbrojtje të kapitalit.

Një nga risqet më të rëndësishme të matshme nga ana sasiore, ndaj të cilit mund të përdoren strategjitë e zbutjes është vlerësuar risku i katastrofave.

Shoqëria Albsig Sh.a., ka përfunduar përpilimin e politikave të ndryshme të cilat janë cituar dhe në planin e menaxhimit të riskut të miratuar në Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë.

Primet nga biznesi i Pronës vijnë në mënyrë vullnetare dhe nga kanalet bankare (mbi 70% e primeve të shkruara bruto në portofolin e pronës janë si kërkesa të bankës për kolaterale).

Zbutja e këtij risku kryhet nëpërmjet risigurimit, si mekanizmi kryesor i transferimit të këtij risku, pasi rreziqet bazë për produktin Zjarri dhe rreziqe shtesë me përfitues bankat e nivelit të dytë ka Zjarr dhe Tërmet.

4.6.1 Kufijtë për risigurim

Shoqëria Albsig Sh.a ka politika të risigurimit që kanë për qëllim përcaktimin e kriterëve dhe metodikën mbi bazën e të cilave lidhen programet e marrëveshjeve të risigurimit në mënyrë që aktiviteti sigures i shoqërisë të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të biznesit nga rreziqe të ndryshme, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Shoqëria Albsig Sh.a risiguron të gjitha risqet apo pjesë të përgjegjësive që ka kontraktuar me të siguarit që tejkalojnë mbulimin maksimal të shoqërisë, të masës 10% të Aftësisë Paguese të shoqërisë Albsig Sh.a.

Marrëveshjet e risigurimit janë nënshkruar vetëm me shoqëritë e risigurimit që përmbushin kushtet sipas Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Risk
Appetite

4.6.2 Administrimi i kapitalit, Niveli i Aftësisë Pagueuse dhe aktivet në mbulim të provigjioneve teknike

Shoqëria ka objektiv kryesor që niveli i kapitalit që do mbajë do të jetë sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Shoqëria do ruajë një nivel marzhi 250% ndaj kufirit minimal të kërkuar të kapitalit, sipas metodës me bazë primet ose dëmet, si dhe do synojë gradualisht dhe mbajtjen e një niveli të paktën 150% të fondit të garancisë.

Kjo strategji do të jetë ruajtja e kërkesave rregullatore në cdo kohë, përdorimi eficient i kapitalit, nëpërmjet analizës së vazhdueshme të treguesve të performancës. Duke patur parasysh kërkesat e legjislacionit në fuqi për nivelin e kapitalit është testuar në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet skenarëve të stresit, për të bërë të mundur zbutjen e rreziqeve që dobësojnë fuqinë e kapitalit. Shoqëria ka testuar, duke bërë provën e rezistencës mbi bazën e shumës së sigurura, pasi nuk ka të dhëna publike në lidhje me probabilitetet dhe dëmet e ndodhura nga katastrofat natyrore në vendin tonë. Në fund të vitit 2018 vlera e fondit të garancisë është brenda të gjitha normave të kërkuara.

4.6.3 Marzhi i aftësisë paguese

Sipas nenit 80 të ligjit 52 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" niveli i kërkuar i Aftësisë Pagueuse të Shoqërisë së Sigurimit është vlera më e lartë midis Fondit të Garancisë (370,000,000 Lekë) dhe 150 përqind të kufirit minimal të aftësisë paguese.

Niveli aktual i aftësisë paguese më 31 dhjetor 2018 është brenda limiteve të kërkuara.

Niveli i kërkuar i aftësisë paguese llogaritur nga Shoqëria si dhe aftësia paguese e saj është si më poshtë:



	Monedha lekë	31.12.2018
1	1.Llogaritja me bazë primet	
2	Prime të shkruara nga aktiviteti i sigurimeve	2,296,025,165
3	Prime të shkruara nga aktiviteti i risigurimeve	-
4	Taksa të zbritshme	-
5	Shuma "a" (5=2+3-4)	2,296,025,165
6	Pjesa e shumës "a" më e vogël se 1,000,000,000 lekë (6=min(1,000,000,000,5))	1,000,000,000
7	Pjesa e shumës "a" më e madhe se 1,000,000,000 lekë (7=5-6)	1,296,025,165
8	Koeficienti i pasigurisë a1 (8=0.18)	0.18
9	Koeficienti i pasigurisë a2 (9=0.16)	0.16
10	Total (10=6*8+7*9)	387,364,026
11	Dëme të paguara bruto	681,813,951
12	Pjesa e risiguruesit në dëmet e paguara	6,114,453
13	Dëme të paguara neto (13=11-12)	675,699,498
14	provigjone bruto të dëmeve në periudhën aktuale	563,446,210
15	provigjone bruto të dëmeve në fund të vitit të kaluar	514,567,431
16	pjesa e risiguruesve në provigjonet e dëmeve në periudhën aktuale	96,020,760
17	pjesa e risiguruesve në provigjonet e dëmeve në fund të vitit të kaluar	26,590,000
18	provigjone neto të dëmeve në periudhën aktuale (18=14-16)	467,425,450
19	provigjone neto të dëmeve në fund të vitit të kaluar (19=15-17)	487,977,431
20	ndryshimi në provigjonet e dëmeve bruto (20=14-15)	48,878,779
21	ndryshimi në provigjonet neto të dëmeve (21=18-19)	(20,551,981)
22	Dëme të ndodhura bruto (22=11+20)	730,692,730
23	Dëme të ndodhura neto (23=21+13)	655,147,517
24	Raporti i mbajtjes (24=max(0.5 , 23/22)	0.90
25	Rezultati nga llogaritja me bazë primet (25=24*10)	347,315,047

Mazhi i aftësisë paguese duke përdorur metodën e kapitalit neto më 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

Elementët e kapitalit	31 dhjetor 2018
A: Kapitali bazë dhe kapitali shtesë (kapitalet e veta sipas pasivit të bilancit)	1,277,499,969
Kapitali aksionar i paguar	879,460,000
Fitimi i akumuluar	398,039,969
B: Elementët e zbritshëm në llogaritjen e kapitalit sipas nenit 79 të ligjit 52/2014	533,410,831
Llogari të tregtueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimit	42,136,108
Të tjera llogari të tregtueshme tregtare (deborë të tjerë)	230,545,998
Inventari	1,962,358
Investime në sipermarrje me interesa pjesëmarrëse	-
Aktivitet Jo-materiale	3,507,163
Garancia e kartonit Jeshil	39,457,374
Element të tjerë të zbritshëm sipas rregullores 87, neni 4.	215,801,830
C: Kapitali (Aftësia paguese) A-B	744,089,138
D: Kufiri minimal i Aftësisë Paguese sipas pikës 3 të nenit 80 të Ligjit Nr.52/2014	347,315,047
E: Fondi i Garancisë sipas nenit 81 të Ligjit 52/2014	370,000,000
F: Niveli i kërkuar i Aftësisë Paguese sipas pikës 2 të nenit 80 të Ligjit Nr.52/2014	520,972,571
G: Mbi (+) / nën (-) nivelin e kërkuar të Aftësisë Paguese (C - F)	223,116,567
H: Mjaftueshmëria e Kapitalit	I Mjaftueshëm

4.6.3 Aktive në mbulim të provigjioneve teknike

Në përputhje me nenin nr. 97 të ligjit 52 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” si dhe rregullores nr. 19 “Për aktivet në mbulim të provigjioneve teknike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve” aktivet në mbulim të rezervës teknike llogaritet si në tabelën e mëposhtme. Gjithashtu në përputhje me Vendimin e Qeverisë nr. 96 datë 03 Gusht 2008, ndryshuar me vendimin nr. 5 datë 7 janar 2009; shoqëritë e sigurimit nuk mund të investojnë më shumë në aktive dhe në rezerva teknike dhe matematikore se përqindjet si më poshtë. Aktivet që mbulojnë rezervën teknike për periudhën e fund vitit 31 dhjetor 2018:

Provigjione teknike bruto			
			1,660,439,533
Aktivt në mbulim të provigjioneve teknike	Kufiri i investimeve në raport me provigjonet	Kufiri i investimit në vlerë sipas rregullores	Të audituara 31 dhjetor 2018
Depozita bankare	pa limit	929,279,612	929,279,612
Të tjera letra borxhi të palistuar - Obligacione	pa limit	8,000,000	8,000,000
Investime të tjera financiare - Dep.Kartonit Jeshil në Byro	pa limit	39,457,374	39,457,374
Toka dhe ndërtesa	30% (10%) secila	685,296,096	498,131,860
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	3% te provigjioneve teknike bruto	42,972,650	42,972,650
Pjesa e risiguruesve në P.T.	25% e totalit	132,927,214	132,927,214
Llogari të arkëtueshme direkt nga aktiviteti	< 90 dite vjetërsi & < 20% PPP	121,224,823	121,224,823
Interesa dhe qira të llogaritura	5%	12,578,074	12,578,074
Aktive afatgjata materiale	5%	93,526,656	83,021,977
Total			1,867,593,583
Provigjione teknike bruto			1,660,439,533
Norma e mbulimit			112%

4.7 Rreziku i cmimeve të sigurimit të detyrueshëm motorik, në vecanti TPL.

Në shoqërinë Albsig Sh.a produkti TPL është një produkt që zë peshë dhe përcaktimi i cmimit të këtij produkti ndikon në arritjen e objektivave strategjike të saj.

Shoqëria edhe për vitin 2018 ka bërë testime në rastin e uljes së primeve të TPL dhe përfundimi ishte që kishim fitim më të ulët për shoqërinë, që ndikon dhe në uljen e aftësisë paguese të shoqërisë.

Ky rrezik është i lartë për të gjithë tregun dhe në rast të destabilizimit të primeve të këtij produkti administrimi i këtij risku është i vështirë dhe do të kishim vonesa në pagesat e dëmeve dhe nënprovigjionim të dëmeve të këtij produkti. Në këtë mënyrë humbet besimin tek klientët, duke dëmtuar dhe linja të tjera të biznesit.

Tregu i sigurimeve shqiptar ka disa vite stabilitet të primeve të këtij produkti por është gjendur në një situatë të tillë, që do të thotë se probabiliteti i ndodhjes është i lartë.

Shoqëria duke e konsideruar element të rëndësishëm në administrimin e riskut monitoron që të ketë ulje të kohës midis raportimit, vlerësimit dhe pagesës së dëmit TPL. Kjo praktikë mundëson provigjionim më të saktë të dëmeve, rrit saktësinë në tarifim dhe ul shpenzimet që vijnë si rrjedhojë e vonesave dhe proceseve gjyqësore.

Gjithashtu shpejtësia në pagesa ndikon në marrëdhëniet me klientët duke arritur kështu një objektiv tjetër strategjik. Gjithsesi diversifikimi i portofolit është një tjetër strategji që shoqëria do të përdorë për zbutjen e këtij rreziku në afatmesëm.

4.8 . Ngritja e reputacionit për të zgjeruar bazën konkurruese.

Shoqëria përzgjedh dhe monitoron me kujdes të gjithë stafin e saj që është në kontakt me klientët, për të kënaqur pritshmëritë e klientëve në të gjitha linjat e biznesit ku shoqëria operon, sepse kontaktet e para me klientët janë shumë të rëndësishme.

Shoqëria ka investuar për një përforsim të logos dhe emrit (brandit) të saj në tregun e sigurimeve.

Ndryshimi i logos për shoqërinë dhe ridimensionimi i të gjithë brandit në një emër në një imazh ka forcuar seriozitetin dhe potencën e shoqërisë për një ecje të sigurt në të ardhmen në vendosjen e standartave më të larta.

Ky element është i domosdoshëm pasi ndikon në arritjen e objektivave strategjike të shoqërisë.

Shoqëria fokus të vecantë i jep risqeve kryesore, por edhe risqeve të tjera që mund të ndërveprojnë me risqet kryesore. Shoqëria i ka gjithmonë në analizë dhe në përditësim për ti menaxhuar sa më mirë në të ardhmen.

4.9 . Planet e vijueshmërisë së veprimtarisë dhe përballimit të situatave të paparashikuara

Plani i vijueshmërisë së veprimtarisë dhe përballimit të situatave të paparashikuara vlerësohen nga shoqëria Albsig sh.a si një risk, i cili duhet administruar me shumë kujdes, nisur nga varësia ndaj sistemeve të IT. Shoqëria i jep rëndësi këtij risku, sepse në rastin e një katastrofe duhet të garantojë vazhdimësinë operacionale të saj dhe ti përgjigjet në kohë dhe shpejtësi kërkesave të klientëve për dëmshpërblim. Shoqëria e ka në objektivin e saj për përmisime cilësore të mëtejshme.

E rëndësishme është për të qenë në monitorim të qëndrueshëm për të gjitha fushat e riskut.

Për këtë shoqëria është gjithmonë e fokusuar në ndërmarrjen e masave për eliminimin apo pakësimin e riskut në nivelin e pranueshëm.

Shoqëria gjithmonë ka një parim se menaxhimi i Riskut është një balancim i një numri elementesh të ndërthurur të cilët ndërveprojnë me njëri tjetrin dhe të cilët kërkojnë që menaxhimi i riskut të jetë efektiv, duke qenë në ekuilibër me njëri tjetrin. Për më tepër, risqe të veçanta nuk mund të adresohen/trajtohen të izoluar nga njëri tjetri, menaxhimi i një risku mund të ketë impakt mbi një risk tjetër apo dhe veprimet e menaxhimit të cilat kanë efekt në kontrollin e më shumë se një risku të vetëm duke bërë të vështirë të jenë njëkohësisht dhe të arritshëm.

Shoqëria është e fokusuar në një raportim efektiv të informacionit kyç të rrezikut të qeverisjes për të siguruar që personat e përfshirë të kenë të gjithë informacionin e nevojshëm për të marrë në konsideratë në procesin e vendimmarrjes.

Një punë nga shoqëria është dhe ngritja e nivelit të ndërgjegjësimit të punonjësve në përgjithësi dhe në veçanti me çështjet që janë të lidhura me menaxhimin e riskut. Kjo me anë të seminareve, trajnimeve në zyrat qendrore të shoqërisë etj.



Risqet e analizuar gjatë vetëvlerësimit janë të kategorizuara si më poshtë:

Analiza e risqeve të lidhura me aktivitetin:

Risku i marrjes në sigurim

Analizat e tarifimit të produkteve (raporte dëme/prime, raporte shpenzime/prime etj) bëhen me bazë 3 – mujore nga aktuari i shoqërisë për produkte të cilat konsiderohen me risk të lartë si kasko, sigurimi i sëmundjeve etj.

Në lidhje me programin e risigurimit për çdo vit shoqëria siguron mbulimin e nevojshëm dhe transferimin e rrezikut që shoqëria nga analizat ka vendosur të mos mbajë.

Varësia nga ndërmjetësit në sigurime si brokera, banka, agjensi udhëtimesh është në nivele të konsiderueshme.

Risku i provigjionimit

Provigjionet në 9-mujor 2018 dhe në fund të vitit 2018 janë testuar nga aktuarët e auditorit të jashtëm dhe kanë rezultuar se janë të mjaftueshme për mbulimin e detyrimeve që ka shoqëria. Në lidhje me indeksimin ndaj inflacionit një masë indeksimi është implicite në metodologjinë e miratuar nga autoriteti dhe tek sigurimi i detyrueshëm motorik në llogaritjen e primit të rrezikut e parashikon efektin e inflacionit.

Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve

Në çdo datë raportimi shoqëria kryen testimin për tu siguruar për mjaftueshmërinë e provigjioneve të dëmeve. Testimet kryesore që kryen janë: Analiza e Raportit të Dëmeve dhe Analiza e Zhvillimit të Provigjioneve të Dëmeve.

Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit dhe individualisht në pjesën më të madhe të linjave të biznesit. Llogaritja bëhet vetëm mbi dëmet dhe mbi dëmet që përfshijnë edhe koston e marrjes në sigurim dhe kosto të tjera të jashtme të lidhura me dëmin. Në kryerjen e kësaj analize shoqëria merr në konsideratë parashikimet aktuale të rrjedhjeve dalëse të parasë. Shoqëria nuk i skonton këto flukse të parashikuara të parasë pasi shumica e dëmeve priten të paguhen brenda vitit.

Në vazhdim, shoqëria kryen një analizë vjetore të zhvillimit të provigjionimit të dëmeve për vlerësimin e metodologjisë së provigjionimit. Kjo analizë kryet mbi RBNS dhe IBNR në baza individuale dhe të kombinuara. Në rast se analiza shfaq mospërputhje të madhe, korrigjimet e duhura bëhen në metodën e provigjionimit. Nëse identifikohet një pamjaftueshmëri e provigjioneve, ajo do t'i ngarkohet menjëherë shpenzimeve duke krijuar një rezervë risku të paskaduar nga humbjet që rezultojnë nga Testi i Mjaftueshmërisë së Rezervave.

4.10. Konkluzione

Nga procesi i vetëvlerësimit të përcaktuar më sipër arrihet në përfundimin që shoqëria ka një nivel të mirë të menaxhimit të risqeve.

Shoqëria është në përpjekje të vazhdueshme në lidhje me risqet për tu përmirësuar në të gjitha drejtimet ku operon duke krijuar një standart të lartë në të ardhmen.

4.11 Rekomandime

Nga vlerësimi i strukturës së shoqërisë dhe efikasitetit të saj për të zbatuar planin e administrimit të riskut dhe për të qenë në përputhje me legjislacionin në fuqi, rezultojnë se struktura e administrimit të riskut në shoqëri të integrohet në nivel operacional dhe të mbikëqyrret nga drejtuesit me ata të pavarur.

Gjithashtu kërkohet një rol më aktiv i komiteteve për të rritur cilësinë e monitorimit dhe përgjegjshmërinë nga Këshilli Mbikëqyrës.

Rreziqet kryesore të trajtuara më lart do të jenë në fokus edhe për vitin 2019.

4.12 Trendet e të ardhmes në industrinë e sigurimeve lidhur me risqet dhe renditja e tyre sipas prioriteteve

Njerëzit kanë një mekanizëm automatik, natyror që bën të harmonizojnë në mënyrë të zakonshme dhe të përqendrohen në të pazakonshmen. Lidhur me të rejat dhe zhvillimet e industrisë së sigurimeve u referohemi listimi i risqeve prezente sot në nivel global dhe rajonal.

Kjo në lidhje me zhvillimet kohore që vijnë me:

Revolucionin e ardhshëm të të dhënave në industrinë e sigurimeve

Mospërputhjen e oreksit të riskut dhe deklaratave të tolerancës së riskut

Referuar zhvillimeve globale po i listojmë në kohën e sotme të zhvillimit të teknologjisë dhe trendeve në industrinë e sigurimeve.

1. Cybersecurity / cybercrime (risiku operacional)

Risku më i lartë përfshin masat e pamjaftueshme të sigurisë kibernetike që çojnë në shkelje të të dhënave / privatësisë, humbje të regjistrimeve ose ngjarje të tjera për shkak të një hack / virus, pajisjes së vjedhur / sulm etj.

Këto probleme mund të shkaktohen nga të huajt me qëllim të keq, në hartimin ose ekzekutimin e sigurisë. Ato mund të çojnë në një kosto të konsiderueshme për tu korrigjuar, riparuar dhe / ose shëruar, si dhe dëmton reputacionin që mund të çojë në humbjen e konsumatorëve.

Ky risk ka qenë një shqetësim i madh gjatë disa viteve të fundit dhe së fundi ka qenë i pranishëm kudo. Meqenëse sigurimi është një biznes i nxitur nga të dhënat, siguria kibernetike shihet si një zonë veçanërisht e ndjeshme për siguresit. Shumë borde janë shumë të shqetësuar për krimin kibernetik, gjë që thekson se ky është një risk me prioritet të lartë që duhet të merret në konsideratë.

2. Fitimi dhe produktiviteti (risiku i sigurimit)

Risku që vjen nga ekspozimi ndaj humbjes financiare nga transaksioni i sigurimeve dhe / ose aktiviteti kur kostot dhe detyrimet në lidhje me një linjë produktesh tejkalojnë pritshmërinë në çmimin e linjës së produktit.

Linjat e produkteve më të reja përjetojnë humbje për shkak të shpenzimeve të larta të operimit të një biznesi të nën-shkallës.

Siguresit janë gjithmonë të shqetësuar për çmimet dhe përfitimin e tyre; dhe çmimi i tregut nuk është gjithmonë i saktë. Ekziston një tundim i vazhdueshëm për të etiketuar një kërcim në pretendimet si një shmangie e përkohshme ose për të ulur normat për të rritur shitjet. Çështjet e çmimeve dhe të fitimit në linjë produktesh janë kryesisht një risk më i lartë

3. IT / sistemet / hendeuku i teknologjisë (risiku operacional)

Në të ardhmen, nevojat operacionale mund të tejkalojnë infrastrukturën ekzistuese të TI-së.

Kur iniciativat teknologjike nuk janë të suksesshme dhe / ose teknologjia e kërkuar për të përmbushur objektivat e biznesit nuk është e disponueshme, firma rrezikon të pritet nga klientët. Jetëgjatësia e sistemit dhe përgjegjësia janë gjithashtu risqe të mëdha. Disa infrastruktura të teknologjisë së siguresve mbështetet në një shitës primar që mund të dështojë. Nevojat operacionale, në të ardhmen, mund të tejkalojnë infrastrukturën ekzistuese të IT-së.

Shumë sigures po luftojnë me këtë risk. Ata po kryejnë burime të mëdha financiare për përmirësimet e sistemeve, por frikësohen se ato do të mbeten prapa kohës kur projekti i përmirësuar përfundon. Siguresit janë shumë të varur nga platforma e tyre e teknologjisë për të kryer veprimtarinë e tyre të biznesit

4. Konkurenca (risiku strategjik)

Risku i pozicionit relativ të tregut të sigurimeve duke u ndikuar nga përparimet strategjike të shoqërive të tjera në të njëjtat tregje. Këto strategji mund të përfshijnë rekrutimin e agentëve, ofrimin e një produkti të ri ose të një skemë përfitimesh ose thjesht çmime më të lira.

Ky risk ekziston për të gjitha bizneset, por sigurimet janë veçanërisht në rrezik për shkak të pengesave të ulëta për hyrje në shumë pjesë të biznesit. Ky risk lidhet me riskun e çmimeve dhe produktin e fitimit (numri 2 më lart) dhe është i nxitur nga të njëjtët faktorë.

5. Nënshkrimi (risiku i sigurimit)

Nënshkrimi është aftësia themelore e parë që nevojitet për një sigures që të ketë sukses.

Risku i humbjeve nga përzgjedhja dhe miratimi i risqeve për t'u siguruar, ose zbatimi i papërshtatshëm i rregullave të sigurimit për risqet që sigurohen. Këto humbje mund të lindin gjithashtu nëse rregullat e sigurimit janë të papërshtatshme për disa situata ose nëse ato janë më pak specifike se sa mund të nevojiten për të sjellë një disiplinë të mirë të nënshkrimit.

Nënshkrimi është aftësia themelore e parë që nevojitet për një sigures që të ketë sukses. Fakti që ai del këtu, si i pesti i 10 rreziqeve më të mëdha, flet për atë se sa tepër e vështirë bëhet nga viti në vit.

6. Legjislativ dhe rregullator (risiku operacional)

Risku i humbjes që lidhet me mosrespektimin e ligjeve, rregullave, rregulloreve, praktikave të përkrahura ose standardeve etike brenda fushës së veprimit.

Efekte e zgjedhjeve elektorale si dhe vendore pritet të ndikojnë potencialisht në mënyrën se si siguresit janë të rregulluar dhe taten në nivel shtetëror dhe lokal.

7. Risku i tregut të investimeve (risiku i investimit)

Humbjet masive të investimeve nga krizat e ndryshme nxit pasigurinë.

8. Drejtimi / mundësitë strategjike të humbura (risku strategjik)

Planifikimi i paefektshëm dhe joefikas i strategjisë mund të rezultojë në shumë vendime të mëdha të arritura në baza ad-hoc.

Risku për të mos pasur një proces efektiv dhe efikas planifikimi strategjik dhe kulturë për të arritur objektiva të rëndësishme të biznesit, të cilat mund të rezultojnë në shumë vendime të mëdha të arritura në baza ad-hoc pa konsideratë të mjaftueshme të kostove, përfitimeve dhe alternativave. Kostoja e mundësive të mungesës së iniciativave të mëdha për shkak të mungesës së prospektit dhe planifikimit efektiv është real.

Strategjia është e lehtë të injorohet në nxehtësinë e bizneseve të përditshme. Kjo është arsyeja pse, për shembull, shoqëritë që janë serioze rreth planifikimit marrin drejtuesit e tyre të papërfshirë në ngarkesat ditore rutinore për të qenë sa më strategjik në drejtimin dhe vendimarrjet në të ardhmen

9. Katastrofa natyrore (risku i sigurimit)

Stuhitë e mëdha duke përfshirë uragane, tornadot përmblyje, zjarre, shkaktojnë humbje të sigurta intensive në një zonë të koncentruar apo edhe nganjëherë të gjerë. Tërmetet janë gjithashtu një kërcënim.

10. Risqet e reja (tipi i panjohur i riskut)



Termi "risqe në zhvillim" përfshin riskun e humbjes nga llojet e ngjarjeve që nuk janë aktualisht në regjistrin e riskut, sepse ato kurrë nuk kanë ndodhur më parë ose sepse konsiderohen jashtëzakonisht të pamundura. Këto mund të jenë "të panjohura".

Risqet e reja janë risku i 10-të më i rrezikshëm

Ne ende nuk e dimë se çfarë do të vijë në të ardhmen, por diçka që nuk parashikohet plotësisht do të na shkaktojë dëm të madh në vitin pasues.

Siguruesit individualë duhet të konsiderojnë zvogëlimin e përparësisë së përpjekjeve të tyre për menaxhimin e riskut në lidhje me:

1. Aksionerët
2. Disponueshmërinë e risigurimit
3. Pretendimet e gabuara
4. Faturimin
5. Konsolidimin e klientëve
6. Sigurinë e punonjësve
7. Përgjegjësinë
8. Likuiditetin
9. Kredinë e risiguruesit



USER INTERFACE

BRONTATA

5. Raporti i Audituesit të Pavarur



RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe aksionarët e Shoqërisë Albsig sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Albsig sh.a** (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2018, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2018, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të shoqërisë **Albsig sh.a** për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 kanë qënë audituar nga një auditues tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pakualifikuar mbi këto pasqyra më 30 prill 2018.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare


Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalië mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

30 prill 2019



Teit Gjini
Auditues Ligjor

Albsig sh.a

(Vlerat janë në Lek)

**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
më 31 dhjetor 2018**

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
AKTIVE			
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	11	42,972,650	56,051,532
Investime	6	1,319,857,686	1,385,748,721
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit	8	163,360,934	134,016,818
Aktive të lidhura me risigurimin	7	132,927,214	117,356,758
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	10	211,845,049	112,157,448
Aktive të tjera	9	60,120,681	61,884,301
Aktive të mbajtura për shitje	12	182,443,846	182,443,846
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	24	323,141,083	307,101,288
Aktive afatgjata materiale	4	800,822,749	441,381,124
Aktive afatgjata jomateriale	5	3,507,163	4,583,553
Aksione në shoqëri të lidhura	13	43,093,733	43,093,733
Totali i aktiveve		3,284,092,788	2,845,819,122
KAPITALI			
Kapitali aksionar		879,460,000	879,460,000
Fitime të akumuluar		282,058,185	196,667,646
Fitimi i ushtrimit		115,981,784	85,390,539
Totali i kapitalit	14	1,277,499,969	1,161,518,185
DETYRIMET			
Rezerva teknike për dëmet	15	563,446,210	514,567,431
Rezervat e primit të pafitur	16	1,096,993,323	978,036,075
Llogari të pagueshme për risigurimet	17	34,824,011	40,468,787
Detyrime ndaj palëve të lidhura	18	8,575,863	51,709,282
Tatim fitim i pagueshëm	28	4,436,905	3,549,918
Detyrime të tjera	19	298,316,507	95,969,444
Totali i detyrimeve		2,006,592,819	1,684,300,937
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		3,284,092,788	2,845,819,122

Span Gjoni
Supri

Emmanuel
Shkollari



Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 41, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	
Prime të shkruara bruto	20	2,338,161,273	1,953,109,277
Ndryshimi në rezervën e primit te pafiturar	16	(118,957,248)	(118,857,076)
Të ardhura bruto nga primet e sigurimit		2,219,204,025	1,834,252,201
Prime të ceduara në risigurim	21	(137,700,501)	(164,569,038)
Ndryshimi në rezervën e primit të risiguresit	7	(53,860,304)	52,361,135
Të ardhura bruto nga primet e sigurimit		2,027,643,220	1,722,044,298
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	22	19,476,925	24,004,547
Të ardhura nga interesi	23	15,137,246	9,830,032
Të ardhura të tjera		14,615,202	4,083,003
Të ardhura të tjera		49,229,373	37,917,582
Të ardhurat neto		2,076,872,593	1,759,961,880
Dëme të paguara të sigurimit	15	(681,813,951)	(363,747,823)
Dëme të paguaranga risiguresi	15	6,114,453	-
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të sigurimit	15	(48,878,779)	(159,772,804)
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të risigurimit	7	69,430,760	26,590,000
Dëme të sigurimit neto		(655,147,517)	(496,930,627)
Kostot e marrjes në sigurim	24	(664,082,910)	(579,780,929)
Shpenzimet administrative	26	(418,725,321)	(331,636,822)
Shpenzime të tjera të sigurimit	25	(150,671,219)	(112,718,039)
Shpenzime financiare neto	27	(45,729,070)	(33,034,826)
Total shpenzime operative		(1,279,208,520)	(1,057,170,616)
Humbje nga shitja e aksioneve	13	-	(91,715,574)
Humbje në ndryshimin e vlerës së mbartur të aksioneve në shoqëri të lidhura	13	-	(3,474,343)
Humbje nga shitja e aktiveve materiale afatgjata		(204,653)	(522,726)
Fitimi i vitit para tatimit		142,311,903	110,147,994
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(26,330,119)	(24,757,455)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	27	(26,330,119)	(24,757,455)
Fitimi i vitit		115,981,784	85,390,539
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		115,981,784	85,390,539

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 41, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Albsig sh.a

(Vlerat janë në Lek)

**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL
më 31 dhjetor 2018**

	Kapitali i nënshkruar	Fitimi i mbartur	Fitimi i vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2017	879,460,000	103,628,795	93,038,851	1,076,127,646
Fitimi i vitit dhe të ardhura të tjera gjithpërfshirëse		85,390,539	85,390,539	85,390,539
Transferim në fitime të mbartura		93,038,851	(93,038,851)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	879,460,000	196,667,646	85,390,539	1,161,518,185
Fitimi i vitit dhe të ardhura të tjera gjithpërfshirëse		115,981,784	115,981,784	115,981,784
Transferim në fitime të mbartura		85,390,539	(85,390,539)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	879,460,000	282,058,185	115,981,784	1,277,499,969

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë më _____ 2019 dhe janë firmosur nga:


Z. Muharrem Bardhoci
Drejtor i Përgjithshëm


Z. Irfan Lami
Drejtor i Finances

Politikat kontabël dhe Shënimet nga faqja 7 deri ne faqen 42 janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare.

Albsig sh.a
(Vlerat janë në Lek)
**PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË
më 31 dhjetor 2018**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Flukset monetare nga aktivitetet operative		
Fitimi neto para tatimit	142,311,903	110,147,994
Rregullime për zërat jo-monetarë në fitim ose humbje:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4,5 28,554,007	27,630,905
Nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve materiale e jomateriale	36,256	1,009,825
Zhvlerësim i të arkëtushmeve	9,091,635	5,134,589
Të ardhurat nga interesi	23 (15,137,246)	(9,830,032)
Shpenzime interesi	66,701	3,665,652
Humbje nga këmbimet valutore	29,222,993	3,474,343
Humbje nga shitja e aksioneve të filialit	-	91,715,574
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin qarkullues	194,146,249	232,948,850
<i>Ndryshimet në zërat operativ</i>		
Llogari të arkëtueshme bruto nga sigurimi	(138,123,352)	(71,469,860)
Aktive të lidhura me risigurimin	(15,570,456)	(78,951,135)
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	(16,039,795)	(45,745,655)
Rritja në aktive të tjera	1,763,620	(7,739,172)
(Renie) \ Rritje në llogari të pagueshme për sigurimet, risigurimet	(5,644,776)	1,037,912
Rritje \ (Renie) në detyrime të tjera	159,213,644	(30,635,304)
Rritje në rezervat e primit të pafiturar	118,957,248	118,857,076
Rritje në rezervat teknike për dëmet	48,878,779	159,772,804
Fluksi monetar gjeneruar nga veprimtaria operative	347,581,161	278,075,516
Tatimi fitimi i paguar	(25,443,132)	(21,207,537)
Interesi i paguar	(66,701)	(3,665,652)
Interesi i arkëtuar	10,678,820	17,949,679
Fluksi monetar neto i gjeneruar nga veprimtaria operative	(14,831,013)	(6,923,510)
Flukset monetare nga aktivitetet investuese:		
Të ardhura nga shitja e njësive të kontrolluara	-	399,069,464
Parapagim të aktiveve afatgjata materiale	(22,000,000)	
Blerje të aktiveve afatgjata materiale	(365,894,129)	(288,905,807)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale	963,497	-
Blerje të aktiveve afat-gjata jo materiale	(24,866)	15,405,448
Rritja \ (Rënia) në investime	41,126,468	(377,838,391)
Fluksi monetar neto i përdorur nga veprimtaria investuese	(345,829,030)	(252,269,286)
Fluksi monetare nga veprimtaritë e financimit		
Dividendët paguar ndaj aksionarëve	-	-
Fluksi monetar neto i përdorur nga veprimtaritë e financimit	-	-
Ndryshimi neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë me to	(13,078,882)	18,882,720
Mjetet monetare dhe ekuivalentë në fillim të vitit	56,051,532	37,168,812
Efekte kursi negative		
Mjetet monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit	11 42,972,650	56,051,532

Politikat kontabël dhe Shënimet nga faqja 7 deri në faqen 41 janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare.

SKEDULE SUPLEMENTARE

Albsig sh.a

(Vlerat janë në Lek)

1. AKTIVE NË MBULIM TË PROVIZIONEVE TEKNIKE

Në përputhje me nenin nr. 97 të ligjit 52 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" si dhe rregullores nr. 19 "Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve" aktivet në mbulim të rezervës teknike llogaritet si në tabelën e mëposhtme. Gjithashtu në përputhje me Vendimin e Qeverisë nr. 96 datë 03 gusht 2008, ndryshuar me vendimin nr. 5 datë 7 janar 2009; shoqëritë e sigurimit nuk mund të investojnë më shumë në aktive dhe në rezerva teknike dhe matematikore se përqindjet si më poshtë. Aktivet që mbulojnë rezervën teknike për periudhën e fund vitit 31 dhjetor 2018:

Aktivet në mbulim të rezervës teknike	Kufiri i investimeve në raport me provigjonet	Kufiri i investimit në vlerë sipas rregullores	Të audituara 31 dhjetor 2018
Depozita bankare	pa limit	929,279,612	929,279,612
Të tjera letra borxhi të palistuara - Obligacione	pa limit	8,000,000	8,000,000
Investime të tjera financiare - Dep.Kartonit Jeshil në Byro	pa limit	39,457,374	39,457,374
Toka dhe ndërtesa	30% (10%) secila	685,296,096	498,131,860
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	3% te provigjoneve teknike bruto	42,972,650	42,972,650
Pjesa e risiguruesve në P.T.	25% e totalit	132,927,214	132,927,214
Llogari të arkëtueshme direkt nga aktiviteti	< 90 dite vjetersi & < 20% PPP	121,224,823	121,224,823
Interesa dhe qira të llogaritura	5%	12,578,074	12,578,074
Aktive afatgjata materiale	5%	93,526,656	83,021,977
Total			1,867,593,583
Provigjone teknike bruto			1,660,439,533
Norma e mbulimit			112%

Albsig sh.a

(Vlerat janë në Lek)

2. MARZHI I AFTSISË PAGUESE

Sipas vendimit nr. 191 datë 25.03.2005 "Për miratimin e metodikës: Për mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e jetës dhe jo-jetës të shoqërive të sigurimit, si dhe elementët që e përbejnë atë" koeficienti i pasigurisë për llogaritjen e të ardhurave është vlera maksimale e pritshme e diferencës midis rrezikut aktual dhe rrezikut të marrë në konsideratë në llogaritje.

b1 = koeficienti i pasigurisë, duke marrë në konsideratë shumën "a" është 0.18

b2 = koeficienti i pasigurisë, i llogaritur duke marrë në konsideratë "a2" është 0.16

Sipas nenit 80 të ligjit 52 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" niveli i kërkuar i Aftësisë Paguese të Shoqërisë së Sigurimit është vlera më e lartë midis Fondit të Garancisë (370,000,000 Lekë) dhe 150 përqind të kufirit minimal të aftësisë paguese. Niveli aktual i aftësisë paguese më 31 dhjetor 2018 është brenda limiteve të kërkuara.

Niveli i kërkuar i aftësisë paguese llogaritur nga Shoqëria si dhe aftësia paguese e saj është si më poshtë:

	Kufiri minimal i Aftësisë paguese, Jo Jetë	ALBSIG	Monedha	31 dhjetor 2018
1	1.Llogaritja me baze primet			
2	Prime të shkruara nga aktiviteti i sigurimeve		leke	2,296,025,165
3	Prime të shkruara nga aktiviteti i risigurimeve		leke	-
4	Taksa të zbritshme		leke	-
5	Shuma "a" (5=2+3-4)		leke	2,296,025,165
6	Pjesa e shumës "a" me e vogel se 1,000,000,000 leke (6=min(1,000,000,000,5))		leke	1,000,000,000
7	Pjesa e shumes "a" me e madhe se 1,000,000,000 leke (7=5-6)		leke	1,296,025,165
8	Koeficienti i pasigurisë a1 (8=0.18)			0.18
9	Koeficienti i pasigurisë a2 (9=0.16)			0.16
10	Total (10=6*8+7*9)		leke	387,364,026
11	Deme të paguara bruto		leke	681,813,951
12	Pjesa e risiguresit në dëmet e paguara		leke	6,114,453
13	Deme të paguara neto (13=11-12)		leke	675,699,498
14	provigjone bruto të dëmeve në periudhën aktuale		leke	563,446,210
15	provigjone bruto të dëmeve në fund të vitit të kaluar		leke	514,567,431
16	pjesa e risiguresve në provigjonet e dëmeve në periudhën aktuale		leke	96,020,760
17	pjesa e risiguresve në provigjonet e dëmeve në fund të vitit të kaluar		leke	26,590,000
18	provigjone neto të dëmeve në periudhën aktuale (18=14-16)		leke	467,425,450
19	provigjone neto të dëmeve në fund të vitit të kaluar (19=15-17)		leke	487,977,431
20	ndryshimi në provigjonet e dëmeve bruto (20=14-15)		leke	48,878,779
21	ndryshimi në provigjonet neto të dëmeve (21=18-19)		leke	(20,551,981)
22	Dëme të ndodhura bruto (22=11+20)		leke	730,692,730
23	Dëme të ndodhura neto (23=21+13)		leke	655,147,517
24	Raporti i mbajtjes (24=max(0.5 , 23/22)			0.90
25	Rezultati nga llogaritja me baze primet (25=24*10)		leke	347,315,047

Albsig sh.a*(Vlerat janë në Lek)***2. MARZHI I AFTËSISË PAGUESE (VAZHDIM)**

Mazhi i aftësisë paguese duke përdorur metodën e kapitalit neto më 31 dhjetor 2018 përbëhet si më poshtë:

Elementët e kapitalit	31 dhjetor 2018
A: Kapitali bazë dhe kapitali shtesë (kapitalet e veta sipas pasivit të bilancit)	1,277,499,969
Kapitali aksionar i paguar	879,460,000
Fitimi i akumuluar	398,039,969
B: Elementët e zbritshëm në llogaritjen e kapitalit sipas nenit 79 të ligjit 52/2014	533,410,831
Llogari të tregtueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimit	42,136,108
Të tjera llogari të tregtueshme tregtare (debitorë të tjerë)	230,545,998
Inventari	1,962,358
Investime në sipermarrje me interesa pjesëmarrëse	-
Aktivitet Jo-materiale	3,507,163
Garancia e kartonit Jeshil	39,457,374
Element të tjere të zbritshem sipas rregullores 87, neni 4.	215,801,830
C: Kapitali (Aftësia paguese) A-B	744,089,138
D: Kufiri minimal i aftësisë paguese sipas pikes 3 ne nenit 80 te Ligjit Nr.52/2014	347,315,047
E: Fondi i Garancise sipas nenit 81 te Ligjit 52/2014	370,000,000
F: Niveli i kerkuar i aftësisë paguese sipas pikes 2 te nenit 80 te Ligjit Nr.52/2014	520,972,571
G: Mbi (+) / nen (-) nivelin e kerkuar te Aftësisë Paguese (C - F)	223,116,567
H: Mjaftueshmeria e Kapitalit	I mjaftueshëm

6. Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm për vitin 2018

6.1. Metodologjia dhe parimet e Auditimit të Brendshëm

6.2. Opinioni i Auditorit të Brendshëm



Raport Vjetor i Auditimit të Brendshëm (Për vitin 2018)

Auditimi i Brendshëm ka kryer angazhimet e tij për vitin 2018 fokusuar në çështjet e klasifikuara me prioritet të lartë dhe me prioritet të mesëm sipas Planit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2018, aprovuar nga Këshilli Mbikqyrës, me vendim Nr. 01, datë 19.01.2018.

Metodologjia dhe parimet e Auditimit të Brendshëm

Auditimi i brendshëm ka ushtruar veprimtarinë e tij në përputhje me Kartën e Auditimit të Brendshëm, kërkesat e rregullores "Për Veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në Shoqërinë e Sigurimit" miratuar me vendimin e Bordit nr. 153, datë 23.12.2014 dhe praktikatat me të mira ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm të rekomanduara nga Instituti Ndërkombëtar i Auditimit të Brendshëm.

Auditimi i brendshëm ka bazuar planifikim e tij për angazhimet që ka ndërmarrë mbi bazën e risqeve me të cilat përballet shoqëria, duke përzgjedhur veprimtaritë me kyçe, me impakt të lartë dhe me ekspozim të konsiderueshëm ndaj tyre.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka kryer angazhimet e planifikuara në Planin Vjetor të Auditimit të Brendshëm, të cilat i janë raportuar manaxhimit në raportet e veçanta të auditimit.

Pavarësia e Auditorit të Brendshëm

Auditimi i brendshëm nuk ka pasur konflikte interesi dhe ka qenë i pavarur dhe i pandikuar nga ndërhyrje për mënyrën e organizimit si dhe nga çdo ndërhyrje në lidhje me përcaktimin e qëllimit, procedurave, shpeshtësisë së kontrollit, apo përmbajtjen e raportit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Brendshëm

Si rezultat i kryerjes së aktiviteteve të auditimit të brendshëm, për vitin 2018, përveç çfarë është raportuar vazhdimisht për tematika të veçanta, **nuk janë evidentuar gjetje kritike ose gabime materiale të cilat të kenë një impakt domethënës në aktivitetin e Shoqërisë.** Janë dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e procedurave, administrimin e informacionit dhe dokumentave si dhe proceseve të ndryshme fokusuar në risk si dhe është monitoruar niveli i realizimit të tyre.

Në mbyllje të procedurave të auditimit për vitin 2018 është vërejtur një nivel i kënaqshëm i kontrolleve të brendshme (qeverisja e Shoqërisë).

Auditimi i Brendshëm



7. Objektivat strategjike dhe vjetore

7.1 Parimet kryesore per zhvillimet ekonomiko - financiare për vitin 2019

- Synimi për të qenë shoqëri lider në treg për cilësinë e shërbimit ndaj klientëve;
- Shërbime cilësore dhe në kohë për klientët individë dhe bizneset nëpërmjet ofrimit të produkteve cilësore të sigurimit ekzistuese dhe të reja dhe pagesa shumë e shpejtë e dëmeve;
- Ruajtja e standarteve të larta në përzgjedhjen e personelit që merret me marrjen në sigurim, shitjen dhe e ndërmjetësive në sigurime;
- Synimi për mbajtjen e ROE minimum 10% ndaj kapitalit të vlerësuar sipas SNRF.

7.2 Objektivat kryesore strategjike vjetore të veprimtarisë së shoqërisë për vitin 2019

Misioni i Shoqërisë ALBSIG SH.A. është shërbimi cilësor në të gjithë klasat e sigurimit të jo - jetës për grupe dhe individë nëpërmjet produkteve cilësore të sigurimit, cilësisë dhe shpejtësisë së pagesës së dëmeve, stabilitetit e ruajtjes të gjendjes financiare.

Veprimtaria e shoqërisë mbështetur në ekperiencën e saj në tregun e sigurimeve jo-jetë, zhvillimeve e tregut si dhe burimeve njerëzore ka përcaktuar objektivat e mëposhtme:

Shoqëria Albsig sha synon që në vitin 2019 të arrijë një pjesë tregu të barabartë me 17 % të primeve të shkruara bruto në sigurimet e jo - jetës dhe pozicionimi i shoqërisë si një nga 2 shoqëritë kryesore të sigurimit të jo - jetës.

Struktura e re organizative për marrjen në sigurim sipas linjave të sigurimit dhe zgjerimi i tyre në burime njerëzore do të shtojë një forcë më të madhe shitjeje në marrjen në sigurim. Ngritja e nivelit profesional të specialistëve të marrjes në sigurim me anë të trajnimeve për linjat kryesore si dhe trendet e veprimtarisë së sigurimit, do të bëjnë të mundur zhvillimet e produkteve të reja për të qenë sa më afër klientit dhe për ti tejcuar besim në të ardhmen.

Shoqëria Albsig ka raportin më të lartë të sigurimit vullnetar në tregun e sigurimeve jo – jetë ne treg për vitin 2018 dhe do të vazhdojë të ketë këtë ritëm në linjat e sigurimit vullnetar me objektiv primar konkretizimin deri 52.63 % të primeve të planifikuara nga portofoli i sigurimeve vullnetare, pra fluksi i të hyrave të predominohet nga linjat vullnetare të sigurimit.

Rritja dhe mbulimi i provigjioneve teknike me burime të mjaftueshme financiare, diktuar nga:

- Zgjerimi i gamës së produkteve;
- Impulset pozitive të rritjes në tërësi të të ardhurave nga linjat e sigurimit vullnetar

Minimizimi i shpenzimeve. Përmirësimi i mëtejshëm i raportit të shpenzimeve administrative me primet, me tendencë plotësimin e standarteve dhe parametrave.

Perfeksionimi i linjave të biznesit nëpërmjet implementimit të skemave sa më optimale të shërbimive të sistemit operacional, etj.

Cilësia e shërbimit të drejtpërdrejtë ndaj klientit e shprehur me një proces efektiv dhe cilësor të marrjes në sigurim dhe me pagesën e shpejtë dhe cilësore të dëmeve të shprehur me nivelin e pagesave dhe provigjionimin real të dëmeve, që përfundimisht do të cojnë në raporte dëme / prime ndjeshëm më të larta se aktualet e tregut.

Lidhja e marrëveshjeve dhe kontratave efektive të risigurimeve me risiguroes seriozë në funksion të rritjes së kapacitetit mbajtës dhe ruajtjes së stabilitetit financiar të shoqërisë.

Me rritje shumë të ndjeshme është parashikuar portofoli i sigurimit të Aksidenteve dhe Shëndetit dhe sigurimit të Pronës. Sigurimi nga Sëmundjet pati një rritje të ndjeshme gjatë viti 2018 dhe do të vazhdojë me prioritet edhe gjatë vitit 2019.

Synohet që edhe gjatë këtij viti të depërtojmë në flotën e mjeteve lundruese dhe ajrore, nëpërmjet sigurimit TPL, Kasko, etj.

Gjatë vitit 2018 në krahasim me vitin 2017 ka patur një rritje të madhe tek produkti përgjegjësi civile (profesionale, aktiviteti, punëdhënësi etj), që edhe për vitin 2019 do të shikohet me prioritet.

Shoqëria synon afrimin e grupeve të ndryshme të klientëve, marketingu i saj do të orientohet prej klientit. Identifikimi i klienteve të mëdhenj, krijimi i bashkëpunimit dhe forcimi i tij përbën prioritet për shoqërinë.



SIGURIMI I SHËNDETIT
NË UDHËTIM

 **ALBSIG**

Vlerat që na bashkojnë.




SIGURIMI FAMILJAR
I SHËNDETIT

www.albsig.al

 **ALBSIG**

Vlerat që na bashkojnë.




**Sigurimi i
Përgjegjësisë së
Pasagjerëve**

 **ALBSIG**

Vlerat që na bashkojnë.

www.albsig.al



SIGURIMI NGA TË GJITHË
RREZIQET NË MONTIM

www.albsig.al

 **ALBSIG**

Vlerat që na bashkojnë.



SIGURIMI I GARANCISË
SË OFERTËS

www.albsig.al

 **ALBSIG**

Vlerat që na bashkojnë.



**SIGURIMI I PËRGJEGJËSISË
SË PRODUKTIT**

 **ALBSIG**

Vlerat që na bashkojnë.



**SIGURIMI I MJETEVE
FLUTURUESE**

www.albsig.al



ALBSIG

Vlerat që na bashkojnë.



SIGURIMI I PARAVE NË UDHËTIM

www.albsig.al

 **ALBSIG**

Vlerat që na bashkojnë.



 **ALBSIG**

Vlerat që na bashkojnë.

**SIGURIMI I PËRGJEGJËSISË CIVILE
PËR TREGTUESIT E NAFTËS
DHE GAZIT**



**SIGURIM NGA TË
GJITHA RREZIQET
NË NDËRTIM**

www.albsig.al



**SIGURIMI I STUDENTËVE
BRENDA DHE
JASHTË SHETIT**

www.albsig.al



SIGURIMI I GARANCISË
SË KONTRATËS

www.albsig.al

 **ALBSIG**

Vlerat që na bashkojnë.



SIGURIMI I SHITËPISË NGA ZJARRI
DHE RREZIQET NATYRORE

 **ALBSIG**

Vlerat që na bashkojnë.

www.albsig.al




SIGURIMI KUFITAR
I MJETIT MOTORRIK

www.albsig.al

 **ALBSIG**

Vlerat që na bashkojnë.



www.albsig.al

Adresa

Albsig sh.a

Rruga e Barrikadave:
Albsig HQ, 1001 Tirane

Telefon

Tel: +355 422 54 764
Cel: +355 682 052 744

Online

Email: info@albsig.al
Website: www.albsig.al

